



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 499/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e dates 04.11.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-61075-06-11-2020 me objekt: *“Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”*, me fond limit 14’016’000 leke pa TVSH, zhvilluar me dt. 06.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Medi-Tel” sh.p.k në procedurën e prokurimit

Ankimues: “Eco Riciklim” sh.p.k
Lagja Mëzez, Rruga dytësore Kashar, ZK 2679, Pasuria 12/22, Tiranë

Subjekte të Interesuara: “Medi-Tel” sh.p.k
Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Rruga Vidhegiate, Ndertesa Nr.18, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.pronësie 41/ Tirane Kashar, MEZEZ,

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.06.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit me Nr. REF-61075-06-11-2020 me objekt: “*Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj*”, me fond limit 14’016’000 leke pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 06.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Në datën 15.06.2020 operatori ekonomik “Eco Riciklim” sh.pk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...]

Me date 12.06.2019, ne SPE eshte publikuar nga Autoriteti Kontraktor "Qendra Spitalore Nene

Tereza", Njoftimi i kontrates dhe Dokumentat e Tenderit, per proceduren me nr. REF-61075-06-11-2020, me objekt " Trajtimi dhe asgjeksi i mbetjeve qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19, marreveshje kuader me afat 12 muaj", me vlere te prishme te kontratave 14'016'000 (katërmbëdhjetë milion e gjashtëmbëdhjetë mijë) Lek pa TVSH.

Nga shqyrtimi i Dokumentave te Tenderit, dhe duke mbajtur ne konsiderate se trajtimi i mbetjeve spitalore eshte nje aktivitet sensitiv qe duhet te realizohet me pergjegjshmeri te larte, pasi ne te kunderten sjell demtime serioze te jetes, shendetit dhe mjedisit, konstatojme se eshte e nevojshme qe kriteret per kualifikim te modifikohen si vijon:

1. Ne Shtojcen 8, pika 3.1.a dhe 3.1.b te Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike.

Nga AK, kerkesat per pikat 3.1.a dhe 3.1.b jane percaktuar si vijon:

a) Leje Mjedisore Tipi B ku te kete te perfshire Autoklaven dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertim pershkruar te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130 C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar ne lejen mjedisore) b) Leje Mjedisore te Tipit A ku te kete te perfshire Inceneratorin dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertim pershkruar te veprimtarise: Trajtim mbetje te rrezikshme (spitalore) me Incenerim.

Nje sere aktesh ligjore e nenligjore rregullojne menyren e trajtimit/asgjesimit te mbetjeve spitalore dhe detyrimet ne lidhje me lejet mjedisore dhe licensimin e ketyre metodave te trajtimit te mbetjeve spitalore. Me konkretisht: keto akte rregullatore jane:

- Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Ligji Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit"
- VKM Nr.798, date 29.9.2010, "Per miratimin e Rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore"
- Udhzuesi Kombetar i Ministrise se Shendetesise "Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore"
- Rregullore Nr. 6, date 30/11/2007 "Per trajtimin e mbetjeve spitalore" e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" percakton sa vijon: Neni 23: 3. Leja e mjedisit per personal fizike a juridike, qe krijojne, grumbullojne, transportojne, magazinojne apo trajtojne mbetje te rrezikshme, percakton kushtet qe duhen permbushur per te siguruar zbatimin e pikes 1 te ketij neni dhe perfshihet ne kategorine III.1 te shtojces bashkelidhur ligjit nr. 10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

Neni 53: Personat fizike a juridike, qe synojne te kryejne operacione per trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisi ne perputhje me ligjin nr. 10 448, date 14. 7.2011 "Per lejet e mjedisit".

Neni 54: 1. Pavaresisht nga kerkesat e ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" dhe nga kerkesat e akteve nenligjore te miratuara ne baze te ketij ligji, leja e mjedisit e referuar ne nenin 53 te ketij ligji, permban, gjithashtu, kushte te tjera qe duhen plotesuar, ku percaktohen: a) llojet dhe sasite e mbetjeve qe trajtohen; b) operacionet qe perfshihen ne leje, kerkesat teknike dhe kerkesat qe lidhen me territorin ne fjale; c) masat e sigurise dhe masat parandaluese qe duhen marre; ç) metoda qe duhet perdorur per

secilin operacion; d) operacionet e monitorimit dhe te kontrollit qe nevojiten; dh) dispozitat per mbylljen dhe kujdesin e metejshem, sipas nevojës.

VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore", ne Kreun IV, "Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjeno - Sanitar", parashikohet shprehimisht: "10.1. Grumbullimi, transportimi, perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shteterore, personat juridike publike, si dhe personat fizike apo juridike private, qe jane pajisur me lejen perkatese per ushtrimin e kesaj veprimtarie."

Emertimet e veprimtarive qe lidhen me menaxhimin e mbetjeve percaktohen ne kategorite 5.1 - 5.4 te Shtojces 1 "Lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi" te Ligjit Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit". Specifikisht ne rastin konkret behet fjale per veprimtarite e percaktuara ne kete Shtojce 1 me ID 5.1.a "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incinerimi" (pika 3.1.b e Shtojces 8 te DST) dhe ID 5.3.a "Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2.a)" (pika 3.1.a e Shtojces 8 te DST).

Nga dispozitat dhe rregullimet e mesiperme, rezulton qarte se nuk mund te kerkohet ne DST qe Leja Mjedisore dhe Licensa perkatese te kete nje emertim te atille pasi nuk perputhet me percaktimet e dispozitave te mesiperme dhe ato te Shtojces 1 te Ligjit Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit". Si rregull, emertimin e zgjedh Agjencia Kombetare e Mjedisit, ne procesin e miratimit te Lejes dhe Licences perkatese dhe eshte ne diskrecionin e AKM detajimi ose jo i metejshem i emertimit re Lejes.

Sidoqofte, te gjitha detajet e veprimtarise te percaktuara ne nenet 23 dhe 54 te Ligjit nr. 10 463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", ku perfshihen edhe kushtet e lejes, natyra, lloji i operacioneve si dhe teknologjite e lejuara, AKM i percakton ne menyre te detajuar ne Akt- Miratimin perkates te Lejes Mjedisore, pa qene e nevojshme qe te ngarkoje emertimin e lejes me elemente qe dalin pertej emertimeve te percaktuar ne Shtojcen 1 te Ligjit Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit".

Ne rrethanat e mesiperme, per te mos kufizuar ne menyre artificiale konkurrencen, kerkojme qe pikat e mesiperme 3.1.a dhe 3.1.b te Shtojces 8 te DST, te modifikohen si vijon:

a. Operatori Ekonomik duhet te disponoje Leje Mjedisore tipi B me kod III.1.B OSE Leje Mjedisore tipi A me kod III.1.C, se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe Licensen Profesionale perkatese te kategorise III.2.B, ku procedura e asgjesimit te jete Autoklavim dhe te perfshije trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore infektive.

b. Operatori Ekonomik duhet te disponoje Leje Mjedisore tipi A me kod III.1.C, se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe Licensen Profesionale perkatese te kategorise III.2.B, ku procedura e asgjesimit te jete me incenerim dhe te perfshije asgjesimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore infektive.

2. Ne Shtojcen 8, pika 3.1.d te Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike

Nga AK, kerkesa per piken 3.1.d eshte percaktuar si vijon:

d. Operatori duhet te paraqese Akt Miratimi Higjeno - Sanitar te impiantit ku kryen aktivitetin, te leshuar nga Inspektoriati Shendetesor Shteteror (ISHSH).

Aktiviteti i objektit te prokurimit ka te beje me administrimin/menaxhimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19, qe

konsiderohen mbetje me koeficient shume te larte rrezikshmerie infektive. Zbatimi i normave dhe rregullave te percaktuara nga ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi gjate ushtrimit te ketij aktiviteti eshte tejet i rendesishem, pasi edhe pasojat qe mund te vijne nga moszbatimi i ketyre rregullave jane pasoja serioze per jeten e shendetin e njerezve.

Pikerisht per shkak te rendesise se madhe qe ka operimi sipas rregullave maksimale te sigurise, eshte e nevojshme gjithashtu qe AK te marre siguri maksimale nga OE ofertues qe ata disponojne te gjitha kapacitetet teknike dhe teknologjike te nevojshme per realizimin e ketij sherbimi. Nisur nga sa me siper, edhe garancite qe duhet te kerkohen prej operateve ekonomike qe konkurojne ne kete objekt prokurimi duhet te jene te shtuara. Keto lloj garancish jane pikerisht garancite ne lidhje me "reputacionin dhe besueshmerine", te percaktuara nga neni 46/1/b I LPP.

Ne keto kushte, na rezulton se kriteri i treguar ne piken 3.1.d te shtojces 8 eshte i paplote, pasi ben fjale ne menyre evazive vetem per "Akt Miratimi Higjeno - Sanitar te impiantit....", nderkohe qe si rregull, OE ekonomike duhet te demonstrojne se disponojne dokumentacion te plote dhe te rregullt per seicilin nga impiantet e kerkuara (specifikisht per impiantin e autoklavimit dhe impiantin e incenerimit).

Per arsyet e mesiperme, vleresojme se eshte e nevojshme qe te modifikohet ky kriter, duke u plotesuar si vijon:

d. Dokument qe verteton se ka ne pronesi ose me qera impjant incenerimi dhe autoklavimi te evidentuar ne Leje Mjedisore, me kapacitet te mjaftueshem per te perballuar llojin dhe sasine e mbetjeve spitalore objekt i ketij prokurimi. Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret duhet te paraqesin per seicilin impiant:

i. Dokument qe provon disponimin nepermjet pronesisee, me qera, apo ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qiraje, fature blerje ose zhdoganimi);

ii. Akt Mtratimi Higjeno - Sanitar te impiantit ku kryen aktivitetin, te leshuar nga Inspektorati Shendetesor Shteteror (ISHSH)

iii. Karten teknologjike te impiantit

iv. Deklaraten e Konformitetit CE te impiantit

3. Ne Shtojcen 8, pika 3.3. te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.9 eshte percaktuar si vijon:

ç. OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe inceneratorit, duhet te paraqese Autodeklarate ku te deklaroje se Autoklava/Hidroklava dhe inceneratori jane te pajisura me printer i cili regjistron dhe printon cdo detaj te procesit te punes (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperatures, Presionin etj.). Autodeklarata duhet te shoqerohet me disa printime (2 ose 3 printime) te autoklaves/hidroklaves dhe inceneratorit, gjate 3 (tre) muajve te fundit nga data e hapjes se procedures.

Nga menyra e fomulimit te ketij kriteri, duket qarte, se qellimi i AK eshte qe te sigurohet qe impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te kerkuara qe te disponohen nga OE ofertues, te jene plotesisht funksionale dhe qe funksionimi i tyre te jete ne perputhje me normat e dispozitat e legjislacionit ne fuqi si dhe me kushtet e percaktuara nga AKM ne ne Lejet Mjedisore perkatese.

Per te orientuar me sakte AK, nga pikepamja teknike dhe e legjislacionit te fushes, duhet te theksojme, se autodeklarata e OE, apo edhe printime te rastesishme te ketyre impianteve sipas ligjit nuk jane te mjaftueshme per te dhene garancite qe kerkon AK. Kjo sepse legjislacioni i fushes,

ka percaktuar mekanizma te posacem monitorimi per funksionimin e rregullt dhe ne perputhje me normat teknike ne fuqi te ketyre impianteve. Keto mekanizma monitorimi jane percaktuar ne menyre te detajuar ne legjislacionin si vijon:

- Ligji nr.10 431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", nenet 41, 42
- Ligji Nr 10 448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit", neni 18
- VKM nr. 1 03, date 31.03.2003 "Per monitorimin e mjedisit ne RSH"
- VKM nr.1189 date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e Programit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit"

Me konkretisht, legjislacioni per lejet e mjedisit dhe per monitorimet ne RSH, ka parashikuar qe cdo subjekt qe operon ne fusha sensitive mjedisore sic eshte edhe menaxhimi i mbetjeve, duhet qe ne menyre periodike (cdo 3 muaj) te dorezoje ne menyre zyrtare prane AKM, Raportet e Vetemonitorimit (RVM) per impiantet me te cilat eshte i pajisur me Leje Mjedisore, RVM te cilat duhet te pergatiten nga eksperte te auditimit mjedisor te licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Per arsytet e mesiperme, kekrojme qe kriteri ne fjale, te modifikohet, duke u saktësuar si vijon:

ç. OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe Inceneratorit, sipas normave teknike te miratuara e te lejuara, duhet te paraqese Raportet e Monitorimit te fundit te dorezuara prane AKM, per instalimet e autoklaves dhe inceneratorit. Ne raport te jene te perfshira flete analizat perkatese te produktit perfundimtar te autoklaves dhe hirit te inceneratorit.

4. Ne Shtojcen 8, pika 3.3.d te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.d eshte percaktuar si vijon:

d. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Qershor 2020, e shoqeruar me listepagesat (formularet Esig 025, me vule elektronike/institucioni) per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise.

Sqarojme, se sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi per procedurat tatimore dhe deklarimet e pagesat e sigurimeve shoqerore e shendetesore, si rregull afati per deklarimin dhe pagesen e sigurimeve shoqerore e shendetesore te cdo muaji, eshte data 20 e muajit pasardhes.

Ne keto kushte, per sa kohe, data e paraqitjes se ofertave eshte percaktuar te jete data 06.07.2020, rezulton qe nuk eshte plotësuar ende ne kete date afati per deklarimet dhe pagesat e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te muajit Qershor.

Nisur nga sa me siper, ne menyre qe mos te vendosen detyrime te parakohshme mbi OE ofertues, kekrojme qe ky kriter te modifikohet si vijon:

d. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Maj 2020, e shoqeruar me listepagesat (formularet E-sig 025, me vule elektronike/institucioni) per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise.

5. Ne Shtojcen 8, pika 3.3.f te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.f eshte percaktuar si vijon:

f) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje autodeklarate ku te deklarohet se te gjitha materialet qe do te perdoren per ambalazhim jane te miratuara nga Institucionet perkatese sipas dispozitave ligjore ne fuqi se rregullojne objektin e prokurimit dhe VKM Nr. 798, date 29.9.2010 Per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" ose ne rastin e eksportit

nderkombetar sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit".

Ne lidhje me kete kriter, se pari sqarojme se sipas Ligjit nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit", per sa i perket ambalazheve qe perdoren gjate transportit te mbetjeve te rrezikshme me potencial te larte infektiv (sic eshte rasti i mbetjeve Covid 19), nuk behet diference ne kerkesen per zbatimin e kerkesave ADR per ambalazhin edhe ne qarkullimin e mbetjeve brenda vendit, pra kerkesa per ambalazh me certifikim ADR duhet te shtrihet edhe per levizjen e mbetjeve per eksport, edhe ne rast te levizjes se tyre per asgjesim brenda vendit.

Gjithashtu, duhet te saktesoje, se sipas Udhezuesit Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore i nxjerre ne zbatim te VKM Nr. 798, date 29.09.2010. Ky Udhezues percakton ne menyre te detajuar ne piken 7.2.3 (fq.23) se bashku me fotot ilustruese (Foto 8 - preferenca per pedal; dhe foto 10 - levizshmeria) se kontenitoret per mbetjet infektive jo te mprehtat) duhet te jene kontenitore plasike njeperdorimesh te pajisur me opsionin e levizshmerise me mekanizem per hapje - mbyllje me pedal, per te menjanuar rrezikun qe vjen nga prekja me duar e kapakeve te kontenitoreve qe mbartin mbetje me potencial te larte infektiv. Ne rrethanat e mesiperme, ne menyre qe AK te marre garanci maksimale per ambalazhet qe do te perdoren, sugjerojme qe ky kriter te modifikohet duke u plotesuar dhe saktesuar si vijon:

f) Operatori Ekonomik duhet te deshmoje se kontenitoret per mbetjet infektive (jo te mprehtat), jane ne perputhje me VKM Nr. 798, date 29.9.2010 Per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" dhe me Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore. Per kete qellim duhet te paraqese:

i: Katalogun per kontenitoret per mbetjet infektive (jo te mprehtat) te pajisura me opsion levizshmerie me mekanizem hapje me pedal

ii. Certificate sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr; 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit",

iii. Moster te kontenitoreve si me siper pershkruar ditin dhe oren e hapjes se ofertave.

6. Ne Shtojcen 9, Specifikimet Teknike, pikat 4, 6 si dhe pikat 14 dhe 15

Ne menyre qe te mos krijohen keqkuptime dhe te harmonizohen keto pika me pjesen tjeter te Dokumentave te Tenderit, sugjerojme qe te saktesohen si vijon:

Pika 4 te behet: 4. Trajtimi/Asgjesimi duhet te realizohet nepermjet metodave per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e ketij vendimi, ku ne vecanti mbetjet e rrezikshme spitalore dhe te kontaminuar qe dalin nga pacientet e infektuar me COVID-19, duhet te trajtohen sipas rastiit me metodat Autoklavim dhe Incenerim.

Pika 6 te behet: "6. Te perdore konteniene njeperdorimesh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi (furnizim qe e kryen OE) sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore dhe me Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore, te cilet duhet te jene te pajisura me opsion levizshmerie me mekanizem

hapje · me pedal dhe me Certificate sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenskrimit"

Pikat 14 dhe 15 konsiderohen si kerkesa per kualifikim dhe jane dhene ne shtojcen 8 Kriteret e Kualifikimit, ndaj sugjerojme te hiqen nga Shtojca 9, pasi jane te panevojshme ketu dhe krijojne konfuzion.

6. Ne Shtojcen 11, "Sherbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit"

Mendojme se ka nje lapsus ne pershkrimin e sherbimit qe kerkohet, pasi flitet per "mbetje te rrezikshme spitalore anatomike te lengeta dhe ngurta", nderkohe qe objekti i kesaj procedure, eshte "Trajtimi dhe asgjeksi i mbetjeve qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19". Per kete arsye sugjerojme te behet saktesimi perkates.

Gjithashtu, ne tabelen e kesaj Shtojce 11, flitet "per nje periudhe deri ne tre muaj", nderkohe qe afatet e ekzekutimit ne njoftimin e kontrates dhe ne gjithe pjesen tjeter te Dokumentave te Tenderit jane 12 muaj. Per kete arsye sugjerojme te behet saktesimi perkates."

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. 2086/4 prot., datë 18.06.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

" [...]Vleresimi Paraprak i KSHA ne lidhje me pretendimet e mesiperme te ngritur ne ankesen e OE "ECO Riciklim" Shpk, sipas pikave perkatese:

Ne zbatim te dispozitave ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, DST-se, si dhe dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses (KSHA), referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik, ku percaktohet se vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim si dhe percaktimi i specifikimeve teknike ka si synim kryesor qe ti sherbeje Autoritetit Kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisje dhe asetete tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe personelin e nevojshern, ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, si dhe duke qene se objekti i ketij prokurimi i ankeses ka nje rendesi te vecante per vete specifikën e ketij sherbimi qe AK ka shpallur per prokurim, kjo pasi ne gjendjen aktuale te krijuar nga pandemia globale Covid - 19, AK QSU "Nene Tereza" eshte institucioni i vetem terciar, ne perberje te te cilit eshte edhe PAI Spitali Infektiv, ku eshte ngritur dhe funksionon spitali Covid-I i percaktuar nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, i cili ben diagnostikimin/monitorimin/trajtimin e pacienteve nga e gjithe Shqiperia te prekur me COVID 19, paciente te cilet marrin trajtimin mjekesor te specializuar, dhe vonesa ne kohe akumulon sasi te konsiderueshme te mbetjeve, te cilat kthehen ne burim potencial infektiv, sidomos ne situaten aktuale ku po shtohen rastet pozitive te te prekurve me Covid - 19. AK gjate periudhes se kesaj pandemie ka funksionuar dhe akoma me shume po funksionon me kapacitet te plote qofte nga ana e stafit mjekesor si mjekte, infermiere, sanitare, punonjes mbeshtetes etj, te cilet per nevoja te situates se krijuar jane

shtuar me personel shtese mjekesor per mbullimin e ofrimit te sherbimit te trajtimit te pacienteve te prekur me kete semundje. Te gjitha mbetjet qe gjenerohen nga pacientet, veshjet e stafit mjekesor, infermior, mbeshtetes etj., jane mbetje potencialisht te rrezikshme infektuese, dhe qe duhen asgjesuar me hidrokлавim dhe incenerim (referuar ne shkresen e Institutit te Shendetit Publik me nr. 417 prot, date 12.03.2020, administruar ne QSUNT me nr. 578/67 prof. date 12. 03.2020 ku citon se: ... trajtimi i tyre behet me hidrokлавim dhe incenerim) per te mos rrezikuar infektimin e stafit mjekesor, personelit mbeshtetes apo per te bere perhapjen e tij ne popullate. Ne shkresen e mesiperme te ISHP referuar situates, kjo e fundit sygjeron qe: [...] gjenerimi i ketyre mbetjeve duhet te incenerohen ne nje incenerator te projektuar mire dhe qe funksionon mire, i cili shkaterron cdo mbetje infektive te rrezikshme, duke i ekspozuar ato ndaj nje temperature mjaft te larte per nje kohe dhe me oksigjen te mjaftueshem, per te djegur lenden organike.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 1, ku citon se:

"1. Ne Shtojcen 8, pika 3.1.a dhe 3.1.b te Kapacitetit ligjor/profesional i operatoreve ekonomike Nga AK, kerkesat per pikat 3.1.a dhe 3.1.b jane percaktuar si vijon:

a) Leje Mjedisore Tipi B ku te kete perfshire Autoklaven dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertimin pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidrokлавim).

Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar me lejen mjedisore)

b) Leje Mjedisore te Tipit A ku te kete te perfshire Inceneratorin dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertimin pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje te rrezikshme (spitalore) me Incenerim.

Nje sere akesh ligjore e nenligjore rregullojne menyren e trajtimit/asgjesimit te mbetjeve spitalore dhe detyrimet ne lidhje me lejet mjedisore dhe licensimin e ketyre metodave te trajtimit te mbetjeve spitalore. Me konkretisht: keto akte rregullatore jane:

- Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Ligji Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit"
- VKM Nr. 798, date 29.9.2010, "Per miratimin e Rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore"
- Udhzuesi Kombetar i Ministrise se Shendetesise "Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore"
- Rregullore Nr. 6, date 30/11/2007 "Per trajtimin e mbetjeve spitalore" e Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave.

Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" percakton si vijon: Neni 23: 3. Leja e mjedisit per personat fizike e juridik, qe krijojne, grumbullojne, transportojne, magazinojne apo trajtojne mbetje te rrezikshme, percakton kushtet qe duhen permbushur per te siguruar zbatimin e pikes 1 te ketij neni dhe perfshihet ne kategorine III 1 te shtojces bashkelidhur ligjit nr. 10081, date 23.2.2009 "Per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise".

Neni 53: Personat fizike a juridike, qe synojne te kryejne operatione per trajtimin e mbetjeve, pajisen me leje mjedisore ne perputhje me ligjin 10448, date 14. 7.2011 "Per lejet e mjedisit".

Neni 54: 1. Pavaresisht nga kerkesat e ligjit nr. 10 448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit" dhe nga kerkesat e akteve nenligjore te miratuara ne baze te ketij ligji, leja e mjedisit e referuar ne nenin 53 te ketij ligji, permban, gjithashtu, kushte te tjera qe duhen plotesuar, ku percaktohen: a) llojet dhe sasite e mbetjeve qe trajtohen; b) operacionet qe perfshihen ne leje, kerkesat teknike dhe kerkesat qe lidhen me territorin ne fjale; c) masat e sigurise dhe masat parandaluese qe duhen marre; c) metoda qe duhet perdorur per secilin operacion; d) operacionet e monitorimit dhe te kontrollit qe nevojiten; dh) dispozitat per mbylljen dhe kujdesin e metejshem, sipas nevojës.

VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore", ne Kreun IV, Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjeno-Sanitar", parashikohet shprehimisht: "10.1. Grumbullimi, transportimi, perpunimi dhe asgjесimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shteterore, personal juridike publike, si dhe personal fizike apo juridike private, qe jane pajisur me lejen perkatese per ushrimin e kesaj veprimtarie. "

Emertimet e veprimtarive qe lidhen me menaxhimin e mbetjeve percaktohen ne kategorite 5.1-5.4 te Shtojces 1 "Lejet e mjedisit te tipave A,B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi" te Ligjit Nr 10448, date 14.07.2011, "Per lejet e Mjedisit". Specifikisht ne rastin konkret behet fjale per veprimtarite e percaktuara ne kete Shtojce 1 me ID 5.1a "Incinerimi i mbetjeve te rrezikshme ne nje instalim incinerim " (pika 3.1. b e Shtojces * te DST) dhe ID 5. 3. a "Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2.a)" (pika 3.1.a e Shtojces 8 te DST).

Nga dispozitat dhe rregullimet e mesiperme, rezulton qarte se nuk mund te kerkohet ne DST qe Leja Mjedisore dhe Licensa perkatese te kete nje emertim te atille pasi nuk perputhet me percaktimet e dispozitave te mesiperme dhe ato te Shtojces I te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e mjedisit". Si rregull, emertimin e zgjedh Agjensia Kombetare e Mjedisit, ne procesin e miratimit te Lejes dhe Licenses perkatese dhe eshte ne diskrecionin e AKM detajimi ose jo i metejshem i emertimit te Lejes.

Sidoqofte te gjitha detajet e veprimtarise te percaktuara ne nenet 23 dhe 54 te Ligjit nr. 10463, date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve ", ku perfshihen edhe kushtet e lejes, natyra, lloji i operacioneve si dhe teknologjite e lejuara, AKM i percakton ne menyre te detajuar ne Akt Miratimin perkates te Lejes Mjedisore, pa qene e nevojshme qe te ngarkoje emertimin e lejes me elemente qe dalin pertej emertimeve te percaktuar ne Shtojcen 1 te Ligjit Nr 10448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit".

Ne rrethanat e mesiperme, per te mos kufizuar ne menyre artificial konkurencen, kerkojme qe pikat e mesiperme 3.1.a dhe 3.1.b te Shtojces 8 te DST, te modifikohen si vijon:

a. Operatori Ekonomik duhet te disponoje Leje Mjedisore tipi B me kod III.1.B OSE Leje Mjedisore tipi A me kod III.1.C, se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe Licensen Profesionale perkatese te kategorise III.2.B, ku procedura e asgjесimit te jete Autoklavim dhe te perfshije trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore infective.

b. Operatori Ekonomik duhet te disponoje Leje Mjedisore tipi A me kod III.1.C, se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe Licensen Profesionale perkatese te kategorise III.2.B, ku procedura e asgjесimit te jete me incenerim dhe te perfshije asgjесimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore infective."

Vete OE ankimues "ECO Riciklim" Shpk, ne kete pike ne lidhje me kriterin e parashikuar ne DST dhe te publikuar ne SPE referon nder te tjera se: Nje sere akesh ligjore e nenligjore rregullojne menyren e trajtimit/asgjesimit te mbetjeve spitalore dhe detyrimet ne lidhje me lejet mjedisore dhe licensimin e ketyre metodave te trajtimit te mbetjeve spitalore.

Saktesisht ne referim te legjislacionit te referuar nga OE ankimues, KSHA vlereson se kerkesat e bera ne DST nga AK, referojne konkretisht kerkesat ligjore ne fuqi qe rregullojne fushen e veprimtarise per objektin e prokurimit, konkretisht:

Keto kerkesa bazohen ne Kreun III, Seksioni II, Neni 28, pika 5, germa a) e VKM. 914 dt. 29.12.2014, si dhe nenit 46 pika 1) germa a) dhe b) e ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" te ndryshuar, shkresen e Institutit te Shendetit Publik (ISHP) nr. 417 prot., date 12.03.2020 (i cili eshte institucioni ad hoc qe ndjek gjendjen e fatkeqesise natyrore te shpallur ne RSH mbi situaten e COVID-19 referuar pikes 5 te VKM Nr. 243, date 24.3.2020 'Per Shpalljen e Gjendjes se Fatkeqesise Natyrore', ku citohet se: Instituti i Shendetit Publik caktohet ne rolin e Sekretariatit Teknik te KNEC-se, per ceshtje te fatkeqesise natyrore te shpallur per shkak te epidemise se shkaktuar nga COVID-19). Me tej, Referuar Katalogut Shqiptar te Mbetjeve, te miratuar me VKM Nr. 99, date 18.2.2005 "Per Miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve", si dhe shkreses se ISHP te sipercituar, keto mbetje jane konsideruar si Kod 180102, dhe metoda me e mire dhe me efikase per te pasur nje mbrojtje maksimale sipas ISHP dhe legjislacionit dhe per te shmangur pasojat qofte mjedisore qofte ne popullate, eshte metoda me hidroklavim/autoklavim dhe pas trajtimit te behet incenerimi i mbetjeve te sterilizuar sipas rekomandimit per incenerim nga ISHP. Kjo nisur dhe nga vete titulli i procedures qe eshte: Trajtim dhe Asgjesim .. , ku referuar VKM Nr. 452, date 11.7.2012 "Per Lendfillet e Mbetjeve", Pika II/f) ku citohet qe: f) "Trajtim" nenkupton proceset (fizike, termike, kimike ose biologjike, perfshire edhe ndarjen) te cilat ndryshojne karakteristikat e mbetjeve me qellim qe te pakesojne vellimin dhe natyren e rrezikshme te tyre, te lehtesojne trajtimin ose te rrisin rikuperimin e tyre .. , pra nevojitet trajtimi dhe me pas asgjesimi i tyre. Temperatura dhe presioni i Hidroklaves/Autoklaves i kerkuar ne DST ne piken qe kundershohet nga OE dhe per te cilen eshte kerkuar te hiqet kjo pike, percaktohet ne Shtojcen 5 'Standarde Teknike per incenerimin dhe Autoklavimin e Mbetjeve Spitalore' te VKM Nr. 798, date 29.9.2010 'Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore', ku mot a mot, citohet se: Sterilizimi duhet te behet me avull ne temperaturen jo me te vogel se 130°C dhe ne presionin jo me te vogel se 1.1 bar.

Ne ligjin Nr.10 448, date 14.7.2011 "Per Lejet e Mjedisit", te ndryshuar, neni 3/11 dhe 3/12 citohet se: 12. "Leje mjedisi e tipit A" eshte leja per veprimtarite e percaktuara ne aneksin I/A, e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, te leshuar nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, teresisht ose pjeserisht, instalimit te tipit A, sipas percaktimit te ketij ligji, dhe qe permban te shkruara kushtet e nevojshme per te garantuar se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime ose pjese te instalimeve ne te njejten vendndodhje dhe qe operohen nga i njejti operator, dhe 13. "Leje mjedisi e tipit B" eshte leja e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila leshohet nga QKL-ja, qe i jep te drejten e funksionimit, teresisht ose pjeserisht, instalimit te tipit B, sipas

percaktimit te ketij ligji dhe qe permban te shkruara kushtet e nevojshme per te garantuar se instalimi permbush kerkesat e ketij ligji dhe te legjislacionit ne fuqi. Nje leje mund te mbuloje nje ose me shume instalime ose pjese te instalimeve ne te njejten vendndodhje dhe qe operohen nga nje i njejti operator.

Siç rezulton ne kerkesen e bere ne DST, ku kerkohet qe: a) Leje Mjedisore Tipi B ku te kete te perfshire Autoklaven dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertim pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130° C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar ne lejen mjedisore). Pra ku kerkohet OE te jete i pajisur me Leje Mjedisore te tipit B, per metoden e autoklavimit/hidroklavimit te mbejeteve te rrezikshme, dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 798, date 29.9.2010 'Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore", autoklava/hidroklava e OE te permbushe kerkesat minimale per sa i perket temperatures dhe presionit te cilat jane te sanksionuara nga legjislatori ne Shtojcen 5 'Standarde Teknike per Incenerimin dhe Autoklavimin e Mbetjeve Spitalore'. Duke qene para faktit se konsiderohen si standarde teknike, ne perputhje me parashikimet e legjislacionit ne fuqi qe rregullojne objektin e prokurimit (trajtimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore te rrezikshme me metoden e autoklavimit / hidroklavimit), nga AK eshte kerkuar qe ne Lejen Mjedisore te OE te tipit B, te pershkruhen standardet teknike minimale qe plotesohen dhe per te cilat OE eshte pajisur me Leje Mjedisore B. Per sa i perket gemes parashikimit b) Leje Mjedisore te Tipit A ku te kete te perfshire Inceneratorin dhe License III.2.B te leshuar nga QKB me Emertim pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje te rrezikshme (spitalore) me incenerim. Sic e citoni dhe vete ne ankese, qe emertimin e zgjedh Agjencia Kombetare e Mjedisit ne procesin e miratimit te Lejes dhe Licenses perkatese dhe sic citoni qe eshte ne diskrecion te AKM detajimi ose jo i metejshe i emertimit te lejes, AK ne perputhje me parashikimet e Kreut III, Seksioni II, Neni 28, pika 5, germa a) te VKM. 914 dt. 29.12.2014, si dhe nenit 46 pika 1) germa a) dhe b) e ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, duke marre shkas nga specifika e objektit te prokurimit, si dhe ne menyre qe te shmange cdo pasoje te mundshme te padeshiruar, ka detajuar dhe specifikuar sipas objektit te prokurimit, kapacitetin qe duhet te kete nje OE/BOE i mundshem ofertues/fitues qe te beje ekzekutimin e kontrates se shpallur, duke garantuar ne te njejten kohe zbatimin me rigorozitet te legjislacionit ne fuqi.

Per kete arsye dhe sa sqaruam dhe argumentuam me siper, KSHA vlereson se pretendimi i ngritur nga OE per piken 1 nuk qendron.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 2, ku citon se:

"2. Ne Shtojcen 8, pika 3.1.d te Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike Nga AK, kerkesa per piken 3.1.d eshte percaktuar si vijon:

d. Operatori duhet te paraqese Akt Miratimi Higjeno - Sanitar te impiantit ku kryen aktivitetin, te leshuar nga Inspektoriati Shendetesor Shteteror (ISHSH).

Aktiviteti i objektit te prokurimit ka te beje me administrimin/menaxhimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19, qe konsiderohen mbetje me koeficient shume te larte rrezikshmerie infektive. Zbatimi i normave dhe rregullave te percaktuara nga ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi gjate ushtrimit te ketij aktiviteti

eshte tejet i rendesishem, pasi edhe pasojat qe mund te vijne nga moszbatimi i ketyre rregullave jane pasoja serioze per jeten e shendetin e njerezve.

Pikerisht per shkak te rendesise se madhe qe ka operimi sipas rregullave maksimale te sigurise, eshte e nevojshme gjithashtu qe AK te marre siguri maksimale nga OE ofertues qe ata disponojne te gjitha kapacitetet teknike dhe teknologjike te nevojshme per realizimin e ketij sherbimi. Nisur nga sa me siper, edhe garancite qe duhet te kerkohen prej operatoreve ekonomike qe konkurojne ne kete objekt prokurimi duhet te jene te shtuara. Keto lloj garancish jane pikerisht garancite ne lidhje me "reputacionin dhe besueshmerine", te percaktuara nga neni 46/1/b I LPP.

Ne keto kushte, na rezulton se kriteri i treguar ne piken 3.1.d te shtojces 8 eshte i paplote, pasi ben fjale ne menyre evazive vetem per "Akt Miratimi Higjenu - Sanitar te impiantit....", nderkohe qe si rregull, OE ekonomike duhet te demonstrojne se disponojne dokumentacion te plote dhe te rregullt per seicilin nga impiantet e kerkuara (specifikisht per impiantin e autoklavimit dhe impiantin e incenerimit).

Per arsyet e mesiperme, vleresojme se eshte e nevojshme qe te modifikohet ky kriter, duke u plotesuar si vijon:

d. Dokument qe verteton se ka ne pronesi ose me qera impjant incenerimi dhe autoklavimi te evidentuar ne Leje Mjedisore, me kapacitet te mjaftueshem per te perballuar llojin dhe sasine e mbetjeve spitalore objekt i ketij prokurimi. Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret duhet te paraqesin per seicilin impiant:

i. Dokument qe provon disponimin nepermjet pronesisee, me qera, apo ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qiraje, fature blerje ose zhdoganimi);

ii. Akt Mtratimi Higjenu - Sanitar te impiantit ku kryen aktivitetin, te leshuar nga Inspektorati Shendetesor Shteteror (ISHSH)

iii. Karten teknologjike te impiantit

iv. Deklaraten e Konformitetit CE te impiantit."

Ne lidhje me sa pretendon OE, KSHA vlereson se Kerkesa e bere na AK ne DST, ku kerkon qe: d) Operatori duhet te paraqese Akt Miratimi Higjenu - Sanitar te impiantit ku kryen aktivitetin, te leshuar nga Inspektorati Shendetesor Shteteror (ISHSH), eshte ne mbeshetje te Kreut III, Seksioni II, Neni 28, pika 5, germa a) e VKM. 914 dt. 29.12.2014, si dhe nenit 46 pika 1) germa a) dhe b) e ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, si dhe ne perputhje te plote me percaktimet e VKM Nr. 798, date 29.9.2010 'Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore', Kreu IV, Leja Mjedisore dhe Akt-Miratimi Higjenu-Sanitar, pika 10.3, ku citohet se: 10.3 Inspektorati Sanitar Shteteror, pas ekspertimit higjenu-shendetesor, leshon aktmiratim higjenu-sanitar per ushtrimin e veprimtarise. Gjithashtu KSHA sqaron OE ankues, se eshte tager ligjor i Autoritetit Kontraktor te vleresoje kriteret e nevojshme qe OE duhet te plotesojne per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese. KShA vlereson se per sa kohe pajisja me aktmiratimin higjenu - sanitar per ushtrimin e veprimtarise, eshte e mundshme, ne perpjestim me natyren e kontrates, dhe per sa kohe eshte detyrim ligjor sipas VKM

798/2010 per cdo OE/BOE qe ushtron kete lloj veprimtarie, vendosja e ketij kriteri nga AK eshte ne perputhje te plote me legjislacionin ne fuqi.

Per kete arsye dhe sa me siper sqaruam/argumentuam, KSHA vlereson se pretendimi i ngritur nga OE per kete pike nuk qendron.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 3, ku citon se:

“3. Ne Shtojcen 8, pika 3.3. te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.9 eshte percaktuar si vijon:

ç. OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe inceneratorit, duhet te paraqese Autodeklarate ku te deklaroje se Autoklava/Hidroklava dhe inceneratori jane te pajisura me printer i cili regjistron dhe printon cdo detaj te procesit te punes (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperatures, Presionin etj.). Autodeklarata duhet te shoqerohet me disa printime (2 ose 3 printime) te autoklaves/hidroklaves dhe inceneratorit, gjate 3 (tre) muajve te fundit nga data e hapjes se procedures.

Nga menyra e formulimit te ketij kriteri, duket qarte, se qellimi i AK eshte qe te sigurohet qe impiantet e autoklavimit dhe inceenrimit te kerkuara qe te disponohen nga OE ofertues, te jene plotesisht funksionale dhe qe funksionimi i tyre te jete ne perputhje me normat e dispozitat e legjislacionit ne fuqi si dhe me kushtet e percaktuara nga AKM ne ne Lejet Mjedisore perkatese.

Per te orientuar me sakte AK, nga pikepamja teknike dhe e legjislacionit te fushes, duhet te theksojme, se autodeklarata e OE, apo edhe printime te rastesishme te ketyre impianteve sipas ligjit nuk jane te mjaftueshme per te dhene garancite qe kerkon AK. Kjo sepse legjislacioni i fushes, ka percaktuar mekanizma te posacem monitorimi per funksionimin e rregullt dhe ne perputhje me normat teknike ne fuqi te ketyre impianteve. Keto mekanizma monitorimi jane percaktuar ne menyre te detajuar ne legjislacionin si vijon:

- Ligji nr.10 431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", nenet 41, 42
- Ligji Nr 10 448, date 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit", neni 18
- VKM nr. 103, date 31.03.2003 "Per monitorimin e mjedisit ne RSH"
- VKM nr.1189 date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e Programit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit"

Me konkretisht, legjislacioni per lejet e mjedisit dhe per monitorimet ne RSH, ka parashikuar qe cdo subjekt qe operon ne fusha sensitive mjedisore sic eshte edhe menaxhimi i mbetjeve, duhet qe ne menyre periodike (cdo 3 muaj) te dorezoje ne menyre zyrtare prane AKM, Raportet e Vetemonitorimit (RVM) per impiantet me te cilat eshte i pajisur me Leje Mjedisore, RVM te cilat duhet te pergatiten nga eksperte te auditimit mjedisor te licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Per arsyet e mesiperme, kekrojme qe kriteri ne fjale, te modifikohet, duke u saktësuar si vijon:

ç. OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe Inceneratorit, sipas normave teknike te miratuara e te lejuara, duhet te paraqese Raportet e Monitorimit te fundit te dorezuara prane AKM, per instalimet e autoklaves dhe inceneratorit. Ne raport te jene te perfshira flete analizat perkatese te produktit perfundimtar te autoklaves dhe hirit te inceneratorit.”

Ne lidhje me kete pretendim, KSHA vlereson dhe sqaron se percaktimi i ketij kriteri nga AK, eshte ne perputhje me parashikimet e bera ne germen b, te pikes 1 te nenit 46 te Ligjit 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, me piken 5, germa ç) te nenit 28, te VKM 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i

ndryshuar ku citohet se: 5. Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: 9) deshmi per mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, si dhe rekomandimine APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e tenderit te procedurave te prokurimit publik". Pajisja me printer i cili regjistron dhe printon cdo detaj te procesit te punes (Ndezja, Hapja e pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperaturën, Presionin etj .. ,) i sherben AK jo vetem qe te garantoje funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe Inceneratorit, por ajo qe eshte me e rendesishme dhe qe kerkohet nga AK, duke marre shkas nga natyra dhe objekti i prokurimit qe eshte 'Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19', pajisja me printer i cili regjistron cdo detaj te punes, garanton AK mbi zbatimin e plote dhe me korrektesi te kontrates, sasine e mbetjeve qe trajtohen/asgjesohen nga OE/BOE i cili do te zbatoje kontraten, si dhe qe trajtimi dhe asgjesimi do te behen sipas parametrave teknike te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi. Kjo i jep mundesine AK qe te monitoroje ne cdo moment qe i lind e nevojshme gjate zbatimit te kontrates, permbushjen e detyrimeve kontraktore dhe te legjislacionit ne fuqi nga OE/BOE i cili do te zbatoje kontraten e shpallur.

Per kete arsye dhe sa sqaruam/argumentuam me siper, KSHA vlereson se pretendimi i ngritur nga OE ankues per kete pike nuk qendron.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 4, ku citon se:

"4. Ne Shtojcen 8, pika 3.3.d te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.d eshte percaktuar si vijon:

d. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Qershor 2020, e shoqeruar me listepagesat (formularët Essig 025, me vule elektronike/institucioni) per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise.

Sqarojme, se sipas akteve ligjore e nelligjore ne fuqi per procedurat tatimore dhe deklarimet e pagesat e sigurimeve shoqerore e shendetesore, si rregull afati per deklarimin dhe pagesen e sigurimeve shoqerore e shendetesore te cdo muaji, eshte data 20 e muajit pasardhes.

Ne keto kushte, per sa kohe, data e paraqitjes se ofertave eshte percaktuar te jete data 06.07.2020, rezulton qe nuk eshte plotesuar ende ne kete date afati per deklarimet dhe pagesat e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te muajit Qershor.

Nisur nga sa me siper, ne menyre qe mos te vendosen detyrime te parakohshme mbi OE ofertues, kekrojme qe ky kriter te modifikohet si vijon:

d. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Maj 2020, e shoqeruar me listepagesat (formularët E-sig 025, me vule elektronike/institucioni) per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise."

KSHA per sa i perket ketij pretendimi te ngritur nga OE, konstaton se duke qene se dorezimi/hapja e ofertave per kete procedure prokurimi eshte parashikuar me date 06.07.2020, muaji Maj 2020 mund te paguhet nga OE/BOE pertej dates 06.07.2020, per kete arsye, AK duhet te ndryshoje kerkesen e bere per muajin Janar - Qershor 2020, duke e ndryshuar/percaktuar shtrirjen kohore per te cilen kerkohen formularët E-sig 025 ne Janar - Maj 2020.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 5, ku citon se:

“5. Ne Shtojcen 8, pika 3.3.f te Kapaciteti teknik

Nga AK, kerkesa per piken 3.3.f eshte percaktuar si vijon:

f) Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje autodeklarate ku te deklarohet se te gjitha materialet qe do te perdoren per ambalazhim jane te miratuara nga Institucionet perkatese sipas dispozitave ligjore ne fuqi se rregullojne objektin e prokurimit dhe VKM Nr. 798, date 29.9.2010 Per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" ose ne rastin e eksportit nderkombetar sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit".

Ne lidhje me kete kriter, se pari sqarojme se sipas Ligjit nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit", per sa i perket ambalazheve qe perdoren gjate transportit te mbetjeve te rrezikshme me potencial te larte infektiv (sic eshte rasti i mbetjeve Covid 19), nuk behet difference ne kerkesen per zbatimin e kerkesave ADR per ambalazhin edhe ne qarkullimin e mbetjeve brenda vendit, pra kerkesa per ambalazh me certifikim ADR duhet te shtrihet edhe per levizjen e mbetjeve per eksport, edhe ne rast te levizjes se tyre per asgjesim brenda vendit.

Gjithashtu, duhet te saktesoje, se sipas Udhezuesit Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore i nxjerre ne zbatim te VKM Nr. 798, date 29.09.2010. Ky Udhezues percakton ne menyre te detajuar ne piken 7.2.3 (fq.23) se bashku me fotot ilustruese (Foto 8 - preferenca per pedal; dhe foto 10 - levizshmeria) se kontenitoret per mbetjet infektive jo te mprehtat) duhet te jene kontenitore plasike njeperdorimesh te pajisur me opsionin e levizshmerise me mekanizem per hapje - mbyllje me pedal, per te menjanuar rrezikun qe vjen nga prekja me duar e kapakeve te kontenitoreve qe mbartin mbetje me potencial te larte infektiv. Ne rrethanat e mesiperme, ne menyre qe AK te marre garanci maksimale per ambalazhet qe do te perdoren, sugjerojme qe ky kriter te modifikohet duke u plotesuar dhe saktesuar si vijon:

f) Operatori Ekonomik duhet te deshmoje se kontenitoret per mbetjet infektive (jo te mprehtat), jane ne perputhje me VKM Nr. 798, date 29.9.2010 Per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" dhe me Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore. Per kete qellim duhet te paraqese:

i: Katalogun per kontenitoret per mbetjet infektive (jo te mprehtat) te pajisura me opsion levizshmerie me mekanizem hapje me pedal

ii. Certifikate sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr; 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimit",

iii. Moster te kontenitoreve si me siper pershkruar ditin dhe oren e hapjes se ofertave.”

Per sa i perket ketij pretendimi, sic kemi sqaruam me siper, si dhe duke marre shkas nga sa percaktohet ne nenin 46 te LPP, eshte kompetence e AK te percaktoje kriteret e nevojshme per zbatimin e kontrates, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese. Legjislacioni ne fuqi percakton qartazi specifikimet/kerkesat e pergjithshme /kodimin/ngjyren/etiketimin etj., qe duhet te permbushin materialet e ambalazhimit per mbetjet e rrezikshme spitalore, per kete arsye, AK ka kerkuar ne forme deklarative qe OE te deklaroje

se do ti permbushi me rigorozitet dhe seriozitet parashikimet ligjore, te cilat jane detyrim ligjor per tu permbushur gjate fazes se zbatimit te kontrates. Sqarohet OE se objekti i prokurimit eshte trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve ... dhe jo furnizimi me materiale per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore. Per kete arsye AK ka vleresuar se forma deklarative e kerkuar eshte mese e mjaftushme.

Per kete arsye KSHA vlereson se pretendimi i ngritur nga OE per kete pike nuk qendron.

Ne lidhje me pretendimin e bere nga OE per piken 6, ku citon se:

"6. Ne Shtojcen 9, Specifikimet Teknike, pikat 4, 6 si dhe pikat 14 dhe 15

Ne menyre qe te mos krijohen keqkuptime dhe te harmonizohen keto pika me pjesen tjeter te Dokumentave te Tenderit, sugjerojme qe te saktosohen si vijon:

Pika 4 te behet: 4. Trajtimi/Asgjesimi duhet te realizohet nepermjet metodave per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e ketij vendimi, ku ne vecanti mbetjet e rrezikshme spitalore dhe te kontaminuar qe dalin nga pacientet e infektuar me COVID-19, duhet te trajtohen sipas rasteve me metodat Autoklavim dhe Incenerim.

Pika 6 te behet: "6. Te persore konteniere njeperdorimesh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi (furnizim qe e kryen OE) sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore dhe me Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore, te cilet duhet te jene te pajisura me opsion levizshmerie me mekanizem hapje me pedal dhe me Certificate sipas kushteve te percaktuara te ambalazhimit "ADR" (Miratuar me ligjin nr. 9272, date 16.09.2004 "Per aderimin e RSH ne Marreveshjen Europiane "Per transportin nderkombetar rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nenshkrimet"

Pikat 14 dhe 15 konsiderohen si kerkesa per kualifikim dhe jane dhene ne shtojcen 8 Kriteret e Kualifikimit, ndaj sugjerojme te hiqen nga Shtojca 9, pasi jane te panevojshme ketu dhe krijojne konfuzion.

6. Ne Shtojcen 11, "Sherbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit"

Mendojme se ka nje lapsus ne pershkrimin e sherbimit qe kerkohet, pasi flitet per "mbetje te rrezikshme spitalore anatomike te lengeta dhe ngurta", nderkohe qe objekti i kesaj procedure, eshte "Trajtimi dhe asgjesimi i mbetjeve qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19". Per kete arsye sugjerojme te behet saktesimi perkates.

Gjithashtu, ne tabelen e kesaj Shtojce 11, flitet "per nje periudhe deri ne tre muaj", nderkohe qe afatet e ekzekutimit ne njoftimin e kontrates dhe ne gjithe pjesen tjeter te Dokumentave te Tenderit jane 12 muaj. Per kete arsye sugjerojme te behet saktesimi perkates."

Per sa i perket pretendimeve te mesiperme, KSHA vlereson se per sa i perket pikes 4, AK duhet te riformuloje kete pike si me poshte:

1. Asgjesimi duhet te realizohet sipas metodave per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e ketij vendimi, ku ne vecanti mbetjet e rrezikshme spitalore dhe te kontaminuar qe dalin nga pacientet e infektuar me COVID-10, duhet te trajtohen me Autoklavim/Hidroklavim dhe Incenerim. Per sa i perket pikes 6 dhe pikes 15, KSHA vlereson se percaktimet e bera ne DST nuk krijojne keqkuptime dhe jane ne harmoni me kerkesat kualifikuese te percaktuara ne DST.

Per sa i perket pikes 14, KSHA vlereson se AK, ne menyre qe te harmonizojë kerkesat e bera nga AK ne DST, duhet te riformuloje kete pike si me poshte:

2. Leje Mjedisore tipi A dhe B, leshuar nga Ministria e Mjedisit/Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimet ne mjedis sipas ligjit Nr.10448, date 14.07.2011, te ndryshuar. Per sa i perket Shtojces 11, KSHA vlereson se AK, ne menyre qe te harmonizojë kerkesat e bera nga AK ne DST, duhet te riformuloje kete pike si me poshte:

“Shtojca 11

SHERBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Sherbimi qe kerkohet: " Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve qe dalin nga sherbimi ku marrin trajtim pacientet me COVID-19, per nje periudhe deri ne dymbëdhjete muaj".

Sasia dhe grafiku i sherbimit do te ekzekutohet sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia Orientuese
I	Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në tre muaj	kg	29200

Afatet e ekzekutimit: **12 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader.**”

Per kete arsye dhe sa eshte argumentuar me siper, si dhe ne kuader te frymes se legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, KSHA ne respektim te detyrimeve qe burojne nga dispozitat e ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar si dhe VKM nr. 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, ka arritur ne,

KONKLuzionin:

1. Te pranoje pjeserisht pretendimet e ngritura nga OE, duke bere ndryshimet ne DST, si me poshte:

I. Ne Seksionin Kapaciteti Teknik, germa d) te riformulohet si me poshte (Ishte/Behet):

ISHTE: d) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Qershor 2020, e shoqeruar me listepagesat iformularet E-sig 025, me vule elektronike/institucioni) per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise.

BEHET: d) Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Janar - Maj 2020, e shoqeruar me listepagesat tformularet E-sig 025, me vule elektronike/institucioni per kete periudhe, ku te figurojne minimalisht 3 punonjes, perfshire edhe stafin e shoqerise.

II. Ne Shtojcen 9, Specifikimet Teknike, Pika 4, te riformulohet si me poshte (Ishte/Behet):

ISHTE: 4. Asgjësimi duhet te realizohet me nje prej metodave per trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e ketij vendimi, ku ne vecanti mbejtjet e rrezikshme spitalore dhe te kontaminuar qe dalin nga pacientet e infektuar me COVID- 10, duhet te trajtohen me Incenerim.

BEHET: 4. Asgjësimi duhet te realizohet sipas metodave per trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore te percaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e ketij vendimi, ku ne vecanti

mbejtjet e rrezikshme spitalore dhe te kontaminuar qe dalin nga pacientet e infektuar me COVID-19, duhet te trajtohen me Autoklavim/Hidroklavim dhe Incenerim.

III. Ne Shtojcen 9, Specifikimet Teknike, Pika 14, te riformulohet si me poshte (Ishte/Behet):
ISHTE: 14. Leje Mjedisore tipi A dhe/ose B, leshuar nga Ministria e Mjedisit/Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimet ne mjedis sipasi ligjit Nr.10448, date 14.07.2011,
BEHET: 14. Leje Mjedisore tipi A dhe B, leshuar nga Ministria e Mjedisit/Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimet ne mjedis sipasi ligjit Nr.10448, date 14.07.2011, te ndryshuar.

IV. Ne Shtojcen 11, Sherbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit, te riformulohet si me poshte (Ishte/Behet):

ISHTE:

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të lëngëta dhe të ngurta” për OSUNT për 12muaj**.

Sasia dhe grafiku i shërbimit do te ekzekutohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia Orientuese
1	Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në 3 (tre) muaj	kg	29200

Afatet e ekzekutimit: **12 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader.**

BEHET:

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”**.

Sasia dhe grafiku i shërbimit do te ekzekutohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia Orientuese
1	Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, për një periudhë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj	kg	29200

Afatet e ekzekutimit: **12 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader.**

II.4. Në datën 26.06.2020, operatori ekonomik “Eco Riciklim” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.5. Në datën 03.07.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 664/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2089/6 prot, datë 03.07.2020, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi hartimin e dokumentave të tenderit dhe trajtimin e ankesës.

II.6. Në datën 17.07.2020 Komisioni i Prokurimit Publik mori Vendimin KPP 258/2020 ku vendosi si vijon:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Eco Riciklim" shpk për procedurën e prokurimit Nr. REF-61075-06-11-2020 me objekt: "Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj", me fond limit 14'016'000 leke pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 06.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza".
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Eco Riciklim" sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

II. 7. Në datën 18.08.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit me Nr. REF-61075-06-11-2020 me objekt: "Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj", me fond limit 14'016'000 leke pa TVSH.

II.8. Në datën 04.09.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

1.	"Eco Riciklim" sh.p.k	9.811.200,00 lekë, skualifikuar
2.	"Pura-Medical" sh.p.k	11.680.000,00 lekë, skualifikuar
3.	"Medi-Tel" sh.p.k	13.432.000,00 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik "Eco Riciklim" është njoftuar nga KVO për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko ligjor të administruar nga OE "ECO RICIKLIM" Shpk në sistemin e prokurimi elektronik (SPE), rezulton se:

1. Ne DST e publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik (SPE) per kete procedure prokurimi, shtojcave me ndryshimet perkatese te publikuara ne SPE, si dhe bazuar ne vendimin e KPP-se nr. 258/2020, date 17.07.2020 i cili ka dhene vendimin e tij perfundimtar per pikat e meposhtme per kete procedure prokurimi. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, 3.1.Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: a) [Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku te kete te perfshire Autoklaven, dhe aktivitet pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava / hidroklava duhet të punojë me temperaturë jo më të vogël se 130o C dhe në presion jo më të vogël se 1.1 Bar (e përshkruar në lejen mjedisore)]

– Ne lidhje me kete pike u konstatua qe OE "ECO RICIKLIM" Shpk nuk e permbush kete kriter pasi, duke u bazuar ne Lejen Mjedisore qe ky OE ka paraqitur, tek "Pershkrimi i veprimtarise se specifikuar" pajisja e tij nuk punon me presion, kusht ky i kerkuar qartesisht nga AK. Per me teper

nga pershkrimi qe eshte bere ne Lejen Mjedisore te ketij OE vihet re se pajisja e tij "Neëster NË50" eshte sterilizues dhe jo autoklave ose hidrokclave.

2. Ne DST e publikuara ne sistemin e SPE per kete procedure prokurimi dhe shtojcave me ndryshimet perkatese te publikuara Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë eshte kerkuar:

c) Operatori duhet të ketë certifikatën ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë", në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ç) Operatori, duhet të ketë certifikatën ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të ambientit" në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

– Ne zbatim te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018 te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilesise jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga republika e Shqiperise.

OE ECO Riciklim ka paraqitur certifikate ISO 9001:2015 me Nr. rregjistrimi 0317100065667 e leshuar me date 01.08.2017 dhe certifikate ISO 14001:2015 me Nr. rregjistrimi 031776065667 date 01.08.2017. Nga certifikatat e paraqitura vihet re se keto certifikata jane leshuar me date 01.08.2017 dhe jane konfirmuar per here te fundit me date 16.09.2018. OE nuk ka paraqitur ndonje konfirmim te auditit vjetor per keto certifikata, i cili eshte i detyrueshem te behet cdo 1 (nje) vit pas leshimit, qe te komfirmoje vlefshmerine vijuese te ketyre certifikatave. Pra, keto certifikata nuk rezultojne te jene te konfirmuara per vlefshmeri nga data 16.09.2018.

3. Ne DST e publikuara ne sistemin e SPE per kete procedure prokurimi dhe shtojcave me ndryshimet perkatese te publikuara, Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik: eshte kerkuar ç) [OE për të vërtetuar funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës].

– OE "Eco Riciklim" Shpk ka paraqitur nje vetedeklarate e cila mban daten 18.08.2020 ne te cilen deklarone se Impiantet e tij jane te lidhur me printera te cilet rregjistrojne dhe printojne cdo detaj te procesit te punes si Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj., Ne printimet qe ky OE ka paraqitur ne DST verehet se printimet e printerit te lidhur me Sterilizuesin jane fotokopje dhe nuk jane as origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as te noterizuara. Gjithashtu vihet re se printeri i lidhur me Sterilizuesin nuk printon presionin, sic eshte kerkuar ne DST, e njejta gje eshte dhe me printimet qe ky OE ka

paraqitur ne SPE verehet se printimet e printerit te lidhur me Inceneratorin jane fotokopje dhe nuk jane as origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as te noterizuara. Gjithashtu vihet re se printimet e paraqitura per Inceneratorin nuk jane te rregullta pasi ne te ka parregullsi te dukshme si:

- Dera e ketij inceneratori rri gjate gjithë kohes e mbyllur, nderkohe qe nga OE pretendohet qe ky incenerator te jete furnizuar me materiale djegje (mbetje spitalore ose medikamente).

- Me daten 23.06.2020 ora 13:37 (referuar te dhenave te paraqitura ne printimet e OE) temperaturat ne te dy dhomat e djegies jane 0 °C, por te dy djegesit rezultojne te jene te ndezur (ON) dhe nuk jane fikur deri ne "rindezjen" e rradhes qe sipas dok te paraqitur rezulton se ka qene data 25.06.2020 ora 19:42.

- Gjithashtu ka gabime te shumta ne daten dhe oren, p.sh midis dates 25.06.2020 del dhe nje date 28.06.2020. Ora shumicen e rasteve shkruan duke u kthyer mbrapa, gje e cila ska sens. P.sh 26.06.2020 ora 01:02 me pas printimi tjetër shkruan date 26.06.2020 ora 00:58, ne vend te ishte te pakten pas ores 01:02.

- Gjithashtu printeri i lidhur me Inceneratorin nuk printon rregullisht pasi verehet qe here-here printon cdo 4-5 min dhe here-here cdo 20-30 min.4.

4. Ne DST Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar: [Të vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklavë/hidroklave) dhe asgjësimit me incenerator, operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill të licencuar apo i eksporton jashtë Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim duhet të dorëzoje:

- Kontratë të vlefshme me Landfill të licencuar per depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.- Kontratë të vlefshme me Landfill të licencuar per depozitimin e hirit qe del nga asgjësimi i mbetjeve spitalore me incenerim.

- Kopje te licences se landfillit (për mbetjet e trajtuara me autoklave dhe per hirin) ku te cilësohet se eshte i licencuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjesh.

- Në rastin e eksportit, Kontratë me subjekt të licencuar për eksportin jashtë RSH ose Autorizim për Eksport të Mbetjeve / Produkteve (hirit) që dalin nga Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve.

OE Eco Riciklim ka paraqitur dy kontrate (akt-marreveshje), me "Albtek Energy shpk" dhe me "Integrated Energy BV SPV shpk", nga verifikimet e kryera verehet se te dyja keto akt-marreveshje jane vetem per mbetjet spitalore te trajtuara, pra vetem per depozitimin e mbetjeve pas trajtimit me Sterilizues (autoklave/hidroklave), dhe jo per depozitimin e hirit qe del nga djegia e mbetjeve spitalore. Vetem tek akt-marreveshja me Albtek Energy shpk, neni 5.1 i kesaj akt-marreveshje shkruhet se Eco Riciklim ne rast se do duhet te depozitopje tipologji tjetër mbetjeje (ne rastin tone Hirin) duhet te beje kerkese me email dhe vetem pas kerkeses duhet te nenshkruajne akt-marreveshje te re. Nga dokumentat e paraqitura ne SPE nga ky OE nuk figuron asnje dokument apo akt-marreveshje qe verteton se ky OE ka per depozitimin e hirit qe del pas djegies se mbetjeve spitalore. Gjithashtu, referuar dhe komunikimit nga ana jone me Agjensine Kombetare te Mjedisit (AKM) si autoritet kompetet ku i kerkuam te na sqaronin nese subjekti "ALBTEK ENERGY" shpk me NIPT: L41914013H eshte i licencuar te grumbulloje nga pale te treta hirin qe del si rezultat i asgjësimit me incenerim te mbetjeve te rrezikshme spitalore infektive? AKM me ane te pergjigjes se saj na informon se operatori "Albtek Energy" disponon leje mjedisore per "Landfillimin e

mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve urbane te qarkut te Elbasanit". Ndersa Landfilli i Tirane me Shoqerine Integrated Energy BV SPV" Shpk, Licensa dhe Leja e Mjedisit bashkelidhur per kete shoqeri, ka pershkrimin e aktivitetit te pershkruar: Grumbullim, ruajtje dhe asgjesim i mbetjeve urbane, dhe Lloji i mbetjeve: "Mbetje urbane dhe mbetjet nga ndertimet/prishjet (jo te rrezikshme)"Per sa me siper argumentuam, OE Eco Riciklim nuk permbush kriteret e percaktuara ne DST nga AK, sipas percaktimeve te nenit 53, pika 3, 5/c, dhe nenit 54 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar."

II.9. Në datën 11.09.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

" [...] Ne nuk jemi dakord me rezultatet e vleresimit si me siper, ne lidhje me skualifikimin e ofertes sone, pasi duke qene se jemi nje operator serioz dhe me lidhje e njohuri shume te mira ne treg, veme re se nga ana e QSUT na eshte rezervuar ne vijimesi nje sjellje dhe trajtim teresisht diskriminues, duke favorizuar haptazi OE MEDI-TEL, oferta e te cilit eshte rreth 3.7 milione leke me e larte se e jona dhe te cilit me sa duket i eshte destinuar nga ana e QSUT, fitimi i kesaj procedure qe nga fillimi.

Se pari, kujtojme se, qe ne ngjizjen e kesaj procedure nga ana e QSUT, kriteret jane hartuar ne menyre te tille qe te veshtiresojne pjesemarrjen tone ne kete gare dhe te favorizojne OE MEDI-TEL. Pavaresisht se KVO i referohet vendimit te KPP nr.258/2020, date 17.07.2020, ky vendim ka bere nje vleresim ne parim te proporcionalitetit te kriterëve ne kushtet kur gara ende nuk ishte zhvilluar, nderkohe qe ka theksuar se vendosja e kriterëve eshte pergjegjesi e AK. Nderkohe nga verifikimi ne praktike i gares, duket qarte se kriteret kane qene te qellimshme per te tentuar perjashtimin tone dhe lenien e gares me nje OE te vetem, pikerisht OE MEDI-TEL.

Se dyti, ne e kemi ofruar sherbimin e evadimit te mbetjeve COVID-19 per QSUT, deri ne 21 Prill 2020, sipas kontrates se lidhur per kete qellim nga MSH. Jo vetem kaq por kontrata ne fjale eshte miratuar madje me VKM. Kjo kontrate eshte realizuar me sukses nga ana jone, duke permbushur te gjitha standardet e nevojshme te percaktuara nga ISHP dhe MSH dhe nuk ka pasur asnje ankese apo evidentim te ndonje mangesie ne lidhje me plotesimin e standarteve teknike nga ana jone si operator ofertues i sherbimit. Sipas qendrimit te KVO ne kete procedure, i bie qe edhe Keshilli i Ministrave, edhe MSH edhe ISHP kane gabuar ne vleresimin tone si te pershtatshem per te realizuar kete sherbim. Pra, brenda te njejtit shtet, madje brenda te njejtës linje varesie institucionale, autoritetet nuk bien dakord me njeri - tjetrin?!!!

Se treti, nje tjeter indicie qe tregon per favorizim dhe preferim te OE MEDI-TEL dhe akordimin atij te kontrates me cmim me te larte dhe demtues per buxhetin e shtetit, eshte fakti i dyshimte se qe nga data 21 Prill 2020 kur ne kemi bere evadimin e fundit te mbetjeve COVID -19 per QSUT sipas kontrates se lidhur nga MSH, deri ne daten 4 Gusht 2020, ka te dhena se QSUT ka bashkepunuar pa asnje baze ligjore dhe kontraktuale me OE MEDI-TEL. Ka te dhena vizuale se automjetet e ketij OE kane operuar pa asnje kontrate dhe baze ligjore ne QSUT.

Se katerti, rezulton nga sistemi i pagesave te thesarit se QSUT ka lidhur nje Kontrate me prokurim te drejtperdrejte me negocim pa shpallje me OE MEDI-TEL, me nr 2444/5

date 4.8.2020, sipas nje Urdheri Prokurimi nr 2444, dt 22.7.2020, nderkohe qe nuk jane ftuar per kete procedure as ne qe ishim kontraktori paraardhes dhe qe kishim realizuar me sukses sherbimin dhe as operatore te tjere te kualifikuar, qe operojne ne kete treg. Qartazi kjo tregon se marredhenia favorizuese dhe bashkepunimi jashte shinave ligjore nga QSUT me OE MEDI-TEL ka filluar prej kohesh dhe shkon pertej vetem kesaj procedure.

Ne vijim po paraqesim kundershkrimet tona per arsyet e skualifikimit tone te evidentuara nga KVO:
1. KVO pretendon se nga ana jone nuk permbushet kriteri 3.1.a i Kriterëve të Vecanta për Kualifikim:

Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 3.1.a kerkohet si vijon:

a) Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku te kete te perfshire Autoklaven, dhe aktivitet pershkruet te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130° C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar ne lejen mjedisore).

Sipas KVO, ky kriter nuk permbushet nga ana jone pasi "... duke u bazuar ne Lejen Mjedisore qe ky OE ka paraqitur, tek "Pershkrimi i veprimtarise se specifikuar" pajisja e tij nuk punon me presion Per me teper nga pershkrimi qe eshte bere ne Lejen Mjedisore te ketij OE vihet re se pajisja e tij "Neëster50" eshte sterilizues dhe jo autoklave ose hidroklave".

Se pari, AK i eshte referuar ne menyre te ngushte e kufizuese Shtojces 3 dhe Shtojces 5 te VKM Nr. 798, date 29.9.2010 "Per Miratimin e Rregullores "Per Administrirnin e Mbetjeve Spitalore", duke justifikuar kerkesen e vet kufizuese qe "Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130° C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar ne lejen mjedisore)", me percaktimin respektiv ne shtojcen 5 "Standartet teknike per Incenerimin dhe Autoklavimin e Mbetjeve Spitalore" te kesaj VKM. Por AK anashkalon faktin qe autoklavimi eshte vetem nje nga teknologjite e trajtimit/asgjesimit te percaktuara ne listen e Shtojces 3 "Metoda per trajtimin dhe asgjesimin" te VKM Nr. 798, date 29.9.2010 brenda metodës së sterilizimit. Sidoqofte kjo liste nuk eshte nje liste e mbyllur dhe ekskluzivisht ezauruese, por eshte nje liste indikuese, pasi teknologjite perparojne dhe ne nje dekada qe ka kaluar nga viti 2010 kur ka dale VKM ne fjale, nuk mund te pretendosh qe nuk jane zhvilluar e miratuar teknologji me te perparuara qe jo domosdoshmerisht jane ekzaktesisht si ato te listuara ne kete Shtojce 3. Per me teper, parametrat e indikuar nga AK i perkasin ekskluzivisht "autoklavimit me presion", pasi njesia matese "Bar" perdoret pikerisht per matjen e presionit atmosferik dhe nuk mund te jene te aplikueshme per nje teknologji te ndryshme qe sidoqofte realizon te njejtin qellim e funksion si p.sh "hidroklava", e cila nuk eshte nje teknologji qe funksionon me presion, por mbi konceptin e realizimit te sterilizimit nepermjet nxehjes se ujit, prodhimit te avullit dhe hidrolizimit te mbetjeve (perfshire copetimin e tyre) deri ne sterilizim te plote.

Me llogjiken e AK, edhe pse p.sh hidroklavimi eshte nje metode e udhezuar nga ISHP, menyra se si eshte shkruar kerkesa per lejen mjedisore do ta linte jashte gares nje OE qe ofron metoden e sterilizimit me hidroklave (te sugjeruar nga ISHP) ose teknologji ekuivalente, pasi ne lejen mjedisore te ketyre OE nuk do te gjehej pershkrimi i funksionimit "...ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar", per arsyen e thjeshte se keto teknologji si hidroklava etj, ekuivalente, nuk perdorin presionin me avull, por procese te tjera teknologjike, qe sidoqofte arrijne te njejtin rezultat, ne mos me te perparuar.

Gjithashtu, hidroklavimi është parashikuar si teknologji në DST nga AK, por në fakt Shtojca 3 e VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 "Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore", nuk e liston fare hidroklavimin si metode specifike për trajtimin sterilizues të mbetjeve spitalore.

Se dyti, sqarojme se KVO tregon padijeni dhe mungese të thelle njohurish të fushës, kur thote se pajisja jone është sterilizues dhe jo autoklave apo hidroklave. Në fakt autoklava në vetvete është "sterilizues me avull" ndërsa hidroklava është "sterilizues me ujë me nxehtësi të lartë". Për metoda gjithëpërfshirëse e trajtimit është sterilizim, ndërsa autoklava, hidroklava apo edhe patenta të tjera të barazvlefshme në rezultat janë teknologji që realizojnë këto qëllim (sterilizimin). Kjo është e qartë edhe nga perkufizimet psh në këto link:

<https://ëëë.cdc.gov/infectioncontrol/guidelines/disinfection/sterilization/steam.html> apo në këto link: <https://en.ëikipedia.org/ëiki/Autoclave>.

Se treti, KVO injoron faktin e qartë ligjor të pershkruar në mënyrë të detajuar në ankesën tone, se autoriteti kompetent për leshimin e Lejeve Mjedisore është Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe është ky autoritet që ka qëllim të vlerësojë nëse një teknologji e caktuar është e pershtatshme dhe e lejuar për të operuar në realizimin e funksioneve dhe mbërritjen e rezultateve specifike të aplikuar. Në këto rrethana, AK nuk mund të përjashtojë nga gara me ane të këtyre përcaktimeve kufizuese që shpiten drejt një OE të vetem, OE të tjere që janë pajisur rregullisht me Leje Mjedisore nga AKM për të realizuar pikerisht shërbimin që kërkon AK, për trajtimin sterilizues të mbetjeve spitalore infektive me autoklavim apo me teknologji ekuivalente. Për të ilustruar sa më siper, bashkelidhim në këto ankesë një konfirmim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit që në cilesinë e autoriteteve kompetente konfirmojnë vlefshmerinë për këto qëllim (për trajtimin e mbetjeve infektive) të teknologjise FHT (Frictional Heat Treatment) që në ngjashëri/ekuivalente me autoklaven/hidroklaen, funksionon nëpërmjet proceseve me copetim/bluarje dhe temperatura 150C të induktuar. Gjithashtu, bashkelidhim edhe Certifikaten e Konformitetit të prodhuesit të kësaj teknologjie.

Se katërti, për të siguruar mirëpërdorim, efikasitet dhe kursim të fondeve publike, sipas parimeve të LPP, KVO duhet të ishte mbështetur posaçërisht për këto pike në nenin 53 pikë 4 të LPP që përcakton se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...", për më tepër në kushtet kur ndryshimi në fjalë në lidhje me parametrat nuk është as një devijim, por ka të bëjë me disponimin e një teknologjie me të përparuar se ajo që ka specifikuar AK dhe, jo vetëm që nuk është thelbesisht material, por është i shkaktuar nga vete AK për shkak të mosnjohjes së teknologjive. Madje, vlen të shtojmë se teknologjia e përdorur prej nesh është identifikuar edhe nga OBSH si teknologji e re, me efikasitet dhe me inovative.

Në konkluzion, është e qartë se ky shkak skualifikimi nuk qëndron dhe ka qenë i planifikuar që në konceptimin e gares me synim eliminimin tone nga gara.

2. KVO pretendon se nga ana jone nuk përmbushet kriteri 3.1.c dhe 3.1ç i Kriterëve të Vecanta për Kualifikim:

Në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pikat 3.1.c dhe 3.1.9, kërkohet si vijon:

c) Operatori duhet të ketë certifikatën ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësive", në përputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

ç) Operatori, duhet te kete certifikaten ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te ambientit" ne perputhje me objektin e prokurimit, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Sipas KVO, ky kriter nuk permbushet nga ana jone pasi "... OE Eco Riciklim ka paraqitur Certifikate ISO 9001:2015 me Nr.Regjistrimi 0317100065667 e leshuar me date 01.08.2017 dhe Certifikate ISO 14001:2015 me Nr.Regjistrimi 031776065667 date 01.08.2017. Nga certifikatat e paraqitura vihet re se keto certifikata jane leshuar me date 01.08.2017 dhe jane konfirmuar **per** here te fundit me date 16.09.2018. OE nuk ka paraqitur ndonje konfirmim te auditit vjetor per keto certifikata, i cili eshte i detyrueshem te behet cdo 1 (nje) vit pas leshimit, qe te konfirmoje vlefshmerine vijuese te ketyre certifikatave. Pra keto certifikata nuk rezultojne te jene te konfirmuara per vlefshmeri nga data 16.09.2018."

Se pari, na lejoni t'ju sjellim ne vemendjen tuaj se eshte shume evidente qe ky shkak skualifikimi eshte sugjeruar nga OE MEDI-TEL, pasi nga shqyrtimi i vendimeve te KPP kemi konstatuar se ka qene pikerisht per te, qe autoritete te tjera kontraktore kane ngritur shkakun e moskonfirmimit vjetor per vlefshmeri vijuese. Sidoqofte, duhet t'ju sqarojme se ne rastin e OE MEDI-TEL, trupa certifikuese nuk ka nje faqe interneti ku mund te verifikohet online vlefshmeria vijuese e certifikates, ndersa ne rastin tone, mjafton te klikohet ne linkun: <https://ëëë.tuv.at/en/certificate-search/> dhe me plotesimin e emrit te shoqerise ne rubriken "Certification of management systems" del qarte se te dyja certifikatat jane aktive. Pra, jo vetem qe certifikatat jane aktive dhe te vlefshme, por trupa certifikuese e jona, TUV, qe eshte me prestigjiozja ne rang nderkombetar, ofron edhe opsonin e kerkimit online ne kohe reale, pikerisht qe vlefshmeria e certifikatave dhe realizimi i auditeve vjetore te verifikohet nga kushdo ne kohe reale. Nese auditet vjetore nuk do te ishin realizuar, statusi i ketyre certifikatave nuk do te rezultonte "aktiv" ne faqen zyrtare te TUV.

Se dyti, aq e thelle eshte padija e KVO per kete ceshtje (dhe me sa duket ndaj e ka pasur te nevojshme te konsultoje OE MEDI-TEL), sa e konsideron daten 16.09.2018 si date te konfirmimit te fundit per vlefshmeri (auditit vjetor), kjo date ne fakt eshte data e ricertifikimit per shkak se kane hyre ne fuqi normat e reja ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 te perditesuara, duke zevendesuar respektivisht Certifikatat ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004 te leshuara per ne me date 01.08.2017.

Ne konkluzion, eshte e qarte se ky shkak skualifikimi nuk qendron dhe me shume gjasa mund te jete sugjeruar nga OE MEDI-TEL me synim eliminimin tone nga gara.

3. KVO pretendon se nga ana jone nuk permbushet kriteri 3.3.c i Kriterëve te Vecanta per Kualifikim:

Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 3.3.ç kerkohet si vijon:

ç) OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe Inceneratorit, duhet te paraqese Autodeklarate ku te deklaroje se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori jane te pajisura me printer i cili regjistron dhe printon cdo detaj te procesit te punes (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperatures, Presionin etj.). Autodeklarata duhet te shoqerohet me

disa printime (2 ose 3 printime) te autoklaves/hidroklaves dhe inceneratorit, gjate 3 (tre) muajve te fundit nga data e hapjes se procedures.

Sipas KVO ky kriter nuk permbushet nga ana jone pasi:

a. Sipas KVO, Printimet si te pajisjes Neëster 50, ashtu edhe ato te Inceneratorit jane fotokopje dhe jo origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as te noterizuara.

Ky pretekst i nxjerre nga KVO jo vetem eshte abuziv dhe tregon haptazi marreveshje me OE MEDI-TEL, por eshte edhe qesharak. Printimet qe jane hedhur ne SPE nga ana jone jane skanime direkte te fleteve sic kane dale nga printerat respective. Mesa duket KVO ka pretenduar qe printimet tona te jene identike sic mund te jene paraqitur nga OE MEDI-TEL qe ne praktiken e vet pajis me vulen e shoqerise se vet cdo dokument edhe kur nuk eshte i prodhuar nga shoqeria. Ne rastin konkret origjinalitetin e printimit nuk e jep vula e shoqerise, por thjesht fakti qe eshte skanuar sic ka dal nga printer, pa asnje nderhyrje ne te apo qofte edhe pa u fotokopjuar para se te skanohet.

b. Sipas KVO, Printimet e pajisjes Neëster 50 nuk tregojne presionin.

E kemi sqaruar me se miri ne piken 1 te kesaj ankese se teknologjia e perdorur nga ne (Neëster) eshte ekuivalente me teknologjine e autoklaves me presion per nga rezultati, vetem zgjidhjet teknike jane te ndryshme: Neëster per te realizuar sterilizimin per dor principin e FHT (frictional heat treatment) trajtim me nxehtesi nga ferkimi, ndersa autoklava per te realizuar sterilizimin, per dor principin e avullit me presion. Pra, nuk e kuptojme cfare presioni pretendon KVO te tregojne pajisja jone, kur ky parameter mund te shfaqet vetem te autoklava klasike. Madje, jo te gjitha autoklavat e tregojne ne printim presonin, pasi keto jane zgjedhje te dizenjimit nga prodhues te vecante. Jo me kot, edhe ne formulimin e kriterit keto parametra jane vendosur ne kllapa, pikerisht per te treguar se jane indikative/orientuese dhe jo te detyrueshme per tu shfaqur ne printimet respektive. Nese do te ishte keshtu, i bie qe te pretendohej evidentimi i presionit edhe tek Inceneratori!!! Absurde!!!

c. Sipas KVO, printimet e inceneratorit nuk jane te rregullta dhe ne to KVO ka verejtur "parregullsi te dukshme" dhe liston disa parametra teknike sipas menyres se vet te leximit/interpretimit.

Se pari, sqarojme, se kriteri nuk permban ndonje kerkese qe printimet duhet te jene "te rregullta" sipas ndonje standarti te percaktuar paraprakisht ne formulimin e kriterit ne DST. Pra kjo menyre vleresimi nga KVO per kete kriter, duke pretenduar parregullsi ne permbajtjen e printimeve eshte ne thelb perdorim i nje kriteri te pakerkuar ne kuptim te nenit 55, pika 2 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se "Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnie kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit."

Se dyti, ne cfare standartesh te gjithepranuara teknike dhe njohurish e kapacitetesh profesionale inxhinierike bazohet KVO, per te bere vleresime te tilla per "parregullsi" te supozuara?!. Pra KVO thjesht "i shkrepet" ti konsideroje te tilla dhe e ben kete ne menyre arbitrare nderkohe qe behet fjale per pajisje shume te specializuara, qe kerkojne inxhiniere te posacem per montimin, venien ne pune, operimin, mirembajtjen, leximin, monitorimin e tyre. Nje sere manualesh e dokumentash teknike, permbajne udhezime te detajuara teknike per pajisjet dhe menyren e lidhjes se ekraneve perkatese me printerat, cka do te thote se kemi te bejme me nje gjuhe me

vete, qe nuk mund te perkthehet ne menyre amatore. Sidoqofte, cdo e dhene e paraqitur ne printimet, eshte e korresponduar nga te dhenat reale, te sakta, te plota dhe te pandryshueshme qe regjistrohen dhe ruhen ne softëarin perkates, i cili eshte i pamodifikueshem dhe ne cdo rast, nese KVO do te kishte ndonje paqartesi mund te kerkonte te verifikonte ne vend softëarin respektiv.

Ne konkluzion eshte e qarte se edhe ky shkak skualifikimi nuk qendron dhe me shume gjasa mund te jete sugjeruar nga OE MEDI-TEL me synim eliminimin tone nga gara.

4. KVO pretendon se nga ana jone nuk permbushet kriteri 3.3.e i Kriterëve te Vecanta per Kualifikim: Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 3.3.e kerkohet si vijon:

e) Te vertetoje nepermjet dokumentacionit se pas trajtimit te mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklave/hidroklave) dhe asgjesimit me incenerator, operatori i dorezon mbetjet e trajtuara ne landfill te licensuar apo i eksporton jashte Republikes se Shqiperise, per kete qellim duhet te dorezoje:

- Kontrate te vlefshme me Landfill te licensuar per depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.

- Kontrate te vlefshme me Landfill te licensuar per depozitimin e hirit qe del nga asgjesimi i mbetjeve spitalore me incenerim.

- Kopje te licences se landfillit (per mbetjet e trajtuara me autoklave dhe per hirin) ku te cilesohet se eshte i licensuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjesh.

- Ne rastin e eksportit, Kontrate me subjekt te licensuar per eksportin jashte RSH ose Autorizim per Eksport te Mbetjeve i Produkteve (hirit) qe dalin nga Trajtimi dhe Asgjesimi i Mbetjeve.

Se pari sqarojme skualifikimin tone:

Sipas KVO, ky kriter nuk permbushet nga ana jone pasi:

a. Sipas KVO, asnje nga Kontratat e dorezuara nga ana jone respektivisht me Albtek Energy (Elbasan) dhe me Integrated Energy BV SPV (Sharre, Tirane), nuk eshte per depozitimin e hirit qe del nga djegia e mbetjeve spitalore.

Ky pretendim i KVO eshte thjesht i pavertete. Nese verifikohet me kujdes Kontrata me Albtek Energy, neni 2.4 referon si pjese integrale aneksin perkates ne te cilen eshte cilesuar se cilat jane llojet e mbetjeve qe pranohen si dhe parametrat e tyre te pranueshme dhe ne kete aneks, hiri eshte nje prej tyre. Per me teper, ne Lejen Mjedisore te Albtek Energy qe eshte pjese perberese e kontrates, ne faqen 37 te saj, qartesisht rezulton se ky subjekt eshte i autorizuar te grumbulloje "Mbetje nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve" qe perfshihen ne grupin e kodeve 19 01, ku perfshihen edhe kodet 19 01 11 dhe 19 01 12, qe jane dy kategorite ku mund te klasifikohet hiri i inceneratorit. Ne kushtet kur ne rastin konkret, mbetjet do te trajtohen fillimisht me sterilizim, pra do te shnderrohen nga te rrezikshme ne te parrezikshme (pra urbane) dhe pastaj do te futen per incenerim, rezulton se kodi i hirit eshte 19 01 12, me perjashtim te ndonje rasti te vecante kur nga analizat mund te rezultojne me kodin 19 01 11.

Sipas KVO nga ana jone duhej te ishte paraqitur nje kontrate shtese e lidhur me Albtek Energy ne menyre te posacme per hirin, pasi sipas KVO hiri qe del nga asgjesimi me incenerim nuk perfshihet ne objektin e kesaj kontrate.

Edhe ky pretendim i KVO, ne vijim te sqarimit te mesiperme eshte i pavertete dhe i pabazuar, pasi objekti i kontrates eshte pikerisht depozitimi i mbetjeve te gjeneruara nga trajtimi me incenerim i mbetjeve spitalore, pra, nuk behet fjale per nje tipologji mbetjesh te paperfshire ne objektin e

kontrates qe te jete e nevojshme nje lajmerim i posacem me email dhe lidhja e nje aneks kontrate. Ne fakt, ne ne vijimesi kemi depozituar hirat tek kjo shoqeri, dhe qe AK te bindet per kete, edhe pse nuk eshte kerkuar ne DST po i bashkelidhim kesaj ankese nje praktike depozitimi.

c. KVO, i referohet edhe nje komunikimi me AKM, ku kjo e fundit i konfirmon se Albtek Energy eshte i pajisur rregullisht me leje mjedisore per landfillimin e mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve ne qarkun e Elbasanit.

Per ne eshte e paqarte cfare do te tregoje KVO me referimin e ketij komunikimi, pasi ne thelb, pergjigja e AKM konfirmon pikerisht qendrimin tone te mesiperm, pra qe shoqeria Albtek Energy eshte e pajisur me Lejen Mjedisore te nevojshme per te grumbulluar hirat e incenerimit.

Se dyti sqarojme kualifikimin e kundraligjshem te OE MEDI-TEL

Pervec sa me siper, do duhet te theksojme edhe faktin se ky qendrim i KVO eshte teresisht diskrimunes dhe favorizues haptazi i shoqerise MEDI-TEL, pasi nderkohe qe ne na ka skualifikuar pa te drejte, per te njejtin kriter, ka kualifikuar shoqerine MEDI-TEL edhe pse ky kriter nuk permbushet prej saj.

Na rezulton nga informacionet e tregut se shoqeria MEDI-TEL per te permbushur kete kriter ne lidhje me depozitimimin e hirit, ka paraqitur nje kontate me shoqerine Polyeco Albania sh.p.k., e cila disponon nje Autorizim Eksporti te Mbetjeve per ti derguar per trajtim/asgjesisim perfundimtar tek shoqeria greke Polyeco S.A., per ato mbetje per te cilat kjo e fundit eshte e autorizuar te trajtoje.

Nga hulumtimi i lejeve dhe licensave te shoqerise Polyeco Albania sh.p.k., ne QKB, na rezulton se kjo shoqeri nuk disponon asnje Leje Mjedisore te vlefshme, qe aktualisht ta lejoje dhe ta autorizojte qe te grumbulloje e te transportoje per eksport mbetjet me kod 19 01 11 ose 19 01 12 qe jane kodet e hirit qe del nga incenerimi/piroliza.

Konkretisht kjo shoqeri ka te regjistruara ne QKB Leje Mjedisore te vitit 2010 dhe 2015, te cilat e kane humbur vlefshmerine e tyre dhe e vetmja Leje Mjedisore active qe aktualisht kjo shoqeri disponon eshte ajo e vitit 2018. Ne kete Leje, kjo shoqeri eshte e autorizuar te grumbulloje dhe te dergoje tek shoqeria Polyeco S.A., ne Greqi vetem mbetjet te cilat shoqeria greke eshte e licencuar te trajtoje dhe ne listen e ketyre mbetjeve nuk perfishihen ato me 19 01 11 dhe/ose 19 01 12. I vetmi kod 19 01 qe ka te listuar ne kete leje kjo shoqeri, eshte ai 19 01 10, qe nuk ka asnje lidhje me kodet ne fjale.

Sigurisht pra, qe vetem Autorizimi i Eksportit te kesaj shoqerie nuk mjafton, per sa kohe, eksporti eshte i kushtezuar si nga pajisja me leje mjedisore perkatese edhe nga aftesia dhe mundesia ligjore e pritesit ne Greqi per te trajtuar keto mbetje.

Ne kushtet kur as Polyeco Albania as Polyeco S.A ne Greqi nuk jane autorizuar respektivisht te insportojne, eksportojne dhe ne vijim te trajtojne/asgjesojne hirin si kategori e mirepercaktuar mbetjesh, lind pyetja: Ku do ti coje OE MEDI-TEL mbetjet e kategorise hi qe del nga incelerimi? A ka nje bashkepunim ne kete rast mes ketyre 2 subjekteve per te kryer shkelje shume te renda te ligjit, qe kane te bejne me shendetin e njerezve, demtimin e mjedisit, por edhe me eksporte te paligjshme dhe kontrabande me mbetje te rrezikshme? A mos valle edhe QSUT po behet promotore e ketyre shkelje serioze, duke mbeshtetur kete kundraligjshmeri flagrante?!!!

Dyshimet shtohen edhe me shume, dhe do te dergohen ne te gjitha autoritetet kompetente te zbatimit te ligjit, kur na rezulton, se QSUT i ka dhene shoqerise Polyeco Albania sh.p.k. edhe kontraten e evadimit te mbetjeve citostatike, qe jane nga kategorite me te rrezikshme te mbetjeve,

ne kushtet kur edhe per kete kod mbetjesh, as kjo shoqeri nuk eshte e pajisur me Leje Mjedisore per grumbullim nga shteti shqiptar, dhe as shoqeria Polyeco S.A. ne Greqi nuk ka leje per trajtimin e tyre. Konkretisht asnjera nga keto dy shoqeri (Polyeco) nuk disponon ne lejet/licensat respektive asnje kod nga titulli 18 "MBETJE NGA KUJDESI SHENDETESOR NJEREZOR OSE SHTAZOR DHE KERKIME QE LIDHEN ME TO" i Katalogut Shqiptar/Europian te mbetjeve, pra as kodin 18 01 08 qe perfshin mbetjet citostatike dhe citotoksike.

Edhe nje here lind pyetja: Ku i dergon mbetjet citostatike qe merr nga QSUT, kjo shoqeri?!

Pas gjithë panorames se mesiperme edhe pse nuk do te deshironim te ishte e vertete, me te drejte na lind pyetja: A mos valle ka nje bashkepunim te miremenduar mes: QSUT - Shoqerise Polyeco Albania sh.p.k, dhe Shoqerise MEDI-TEL sh.p.k.?!?!

Ne perfundim, pasi parashtruam sa me siper, kerkojme te rishikohet vleresimi i bere nga KVO dhe Oferta jone te kualifikohet dhe te pranohet; ndersa oferta e OE MEDI-TEL te skualifikohet dhe te refuzohet."

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 2819/3 prot., datë 24.09.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si vijon:

"[...] ."

1.Operatori Ekonomik "ECO RIKIKLIM" SHPK ka pretendime ne lidhje me Kriteret e vecanta te kualifikimit pika 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike eshte kerkuar ne pikat c dhe c:

c)Operatori duhet te kete certifikaten ISO 9001 :2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise", në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ç) Operatori, duhet të ketë certifikatën ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të ambientit" në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Referuar ankeses se bere nga Operatori Ekonomik "ECO RIKIKLIM" SHPK Komisioni i Shqyrtimit te Ankesa pasi shqyrtoi ankesen dhe administroi dosjen e kesaj procedure konstatoi se: Operatori ekonomik ECO RIKIKLIM SHPK ka paraqitur origjinale dhe te noterizuar certifikaten ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise" dhe certifikaten ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit te ambientit" sipas kerkesave te DST.

Rrjedhimisht pranohet pretendimi i ngritur nga ana e OE "ECO RIKIKLIM" SHPK

2.Operatori Ekonomik "ECO RIKIKLIM" SHPK ka pretendime ne lidhje me Kriteret e vecanta te kualifikimit pika 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar eshte kerkuar:

Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.2), te leshuar nga QKB me emertim pershkrues te veprimparise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava/hidroklava duhet te punoje me temperature jo me te vogel se 130° C dhe ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar (e pershkruar ne lejen mjedisore)].

Referuar ankeses se bere nga Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi shqyrtoi ankesen dhe administroi dosjen e kesaj procedure konstatoi se:

Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK, bazuar ne Lejen Mjedisore qe ky OE ka paraqitur, tek "Pershkrimi i veprimtarise se specifikuar" pajisja e tij nuk punon me presion, kusht ky i kerkuar qartesisht ne DST nga AK.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik nuk pranohet pasi nuk eshte ne perputhje me kriteret e vendosura ne DST.

3.Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK ka pretendime ne lidhje me Kriteret e vecanta te kualifikimit piken 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar:

ç) OE per te vertetuar funksionalitetin e Autoklaves/Hidroklaves dhe Inceneratorit, duhet te paraqese Autodeklarate ku te deklaroje se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori jane te pajisura me printer i cili regjistron dhe printon cdo detaj te procesit te punes (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperatures, Presionin etj.). Autodeklarata duhet te shoqerohet me disa printime (2 ose 3 printime) te autoklaves/hidroklaves dhe inceneratorit, gjate 3 (tre) muajve te fundit nga data e hapjes se procedures.

Referuar ankeses se bere nga Operatori Ekonomik "ECORICIKLIM" SHPK Komisioni i Shqyrtimit te Ankesa pasi shqyrtoi ankesen dhe administroi dosjen e kesaj procedure konstatoi se: Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK ka paraqitur nje vetëdeklarate e cila mban daten 18.08.2020 ne te cilen deklaroi se Impiantet e tij jane te lidhur me printera te cilet rregjistrojne dhe printojne cdo detaj te procesit te punes si Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit te Punes, Temperatures, Presionin etj.,

Lidhur me kete, rezultoi se printeri i lidhur me Impiantin e tij nuk printon presionin, sic eshte kerkuar ne DST, e njeja gje konstatohet dhe me printimet qe ky OE ka paraqitur ne SPE, Gjithashtu vihet re se printimet e paraqitura per Inceneratorin nuk jane te rregullta pasi ne te ka parregullsi te dukshme si: Dera e ketij inceneratori tregon gjate gjithë kohes e mbyllur (Closed), nderkohe qe nga OE pretendohet qe ky incenerator te jete furnizuar me materiale djegje (mbetje spitalore ose medikamente) dhe nuk tregon ne asnje moment e hapur (Open) ne te gjitha printimet e paraqitura nga OE.

Me daten 23.06.2020 ora 13:37 (referuar te dhenave te paraqitura ne printimet e OE) temperaturat ne te dy dhomat e djegies jane 0°C, pra te dy djegesit rezultojne te jene te ndezur (ON) dhe nuk jane fikur deri ne "rindezjen" e rradhes qe sipas dok te paraqitur rezultoi se ka qene data 25.06.2020 ora 19:42.

Gjithashtu ka gabime te shumta ne daten dhe orën, p.sh midis dates 25.06.2020 del dhe nje date 28.06.2020. Ora shumicen e rasteve shkruan duke u kthyer mbrapa, gje e cila ska sens. P.sh 26.06.2020 ora 01:02 me pas printimi tjeter shkruan date 26.06.2020 ora 00:58, ne vend te ishte te pakten pas ores 01:02. Pra, nuk ka nje renditje kronologjike te veprimeve te pajisjes.

Pretendimi i Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK nuk pranohet.

4.Operatori Ekonomik "ECORICIKLIM" SHPK ka pretendime ne lidhje me Kriteret e vecanta te 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar:

e) Te vertetoje nepermjet dokumentacionit se pas trajtimit te mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklave/hidroklave) dhe asgjесimit me incenerator, operatori i dorezon mbetjet e trajtuara ne

landfill te licensuar apo i eksporton jashte Republikes se Shqiperise, per kete qellim duhet te dorezoje:

-Kontrate te vlefshme me Landfill te licensuar per depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.

-Kontrate te vlefshme me Landfill te licensuar per depozitimin e hirit qe dhe nga asgjesimi i mbetjeve spitalore me incenerim.

-Kopje te licences se landfillit (per mbetjet e trajtuara me autoklave dhe per hirin) ku te cilesohet se eshte i licensuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjesh.

-Ne rastin e eksportit, Kontrate me subjekt te licensuar per eksportin jashte RSH ose Autorizim per Eksport te Mbetjeve i Produkteve (hirit) qe dalin nga Trajtimi dhe Asgjesimi i Mbetjeve. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesa pasi shqyrtoi ankesen dhe administroi dosjen e kesaj procedure konstatoi se:

Operatori Ekonomik "ECO RICIKLIM" SHPK ka paraqitur dy kontrate (akt-marreveshje), me "Albtek Energy shpk" dhe me "Integrated Energy BV SPV shpk". Nga verifikimet e kryera verehet se te dyja keto akt-marreveshje jane vetem per mbetjet spitalore te trajtuara, pra vetem per depozitimin e mbetjeve pas trajtimit me Sterilizues (autoklave/hidroklave), dhe jo per depozitimin e hirit qe del nga djegia e mbetjeve spitalore. Vetem tek akt-marreveshja me Albtek Energy shpk, neni 5.1 i kesaj akt-marreveshje shkruhet se Eco Riciklim ne rast se do duhet te depozitoje tipologji tjeter mbetjeje (ne rastin tone Hirin) duhet te beje kerkese me email dhe vetem pas kerkeses duhet te nenshkruajne akt-marreveshje te re. Nga dokumentat e paraqitura ne SPE nga ky OE nuk figuron asnje dokument apo akt-marreveshje qe verteton se ky OE ka per depozitimin e hirit qe del pas djegies se mbetjeve spitalore. Gjithashtu, referuar dhe informacionit percjelle nga Agjencia Kombetare e Mjedisit si autoritet kompetent ku i eshte kerkuar te sqarohet nese subjekti "ALBTEK ENERGY" shpk me NIPT: L41914013H eshte i licencuar te grumbulloje nga pale te treta hirin qe del si rezultat i asgjesimit me incenerim te mbetjeve te rrezikshme spitalore infective, AKM me ane te pergjigjes se saj na informon se operatori "Albtek Energy" disponon leje mjedisore per "Landfillimin e mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve urbane te qarkut te Elbasanit". Ndersa Landfilli i Tirane me Shoqerine Integrated Energy BY SPY" Shpk, Licensa dhe Leja e Mjedisit bashkelidhur per kete shoqeri, ka pershkrimin e aktivitetit te pershkruar: Grumbullim, ruajtje dhe asgjesim i mbetjeve urbane, dhe Lloji i mbetjeve: "Mbetje urbane dhe mbetjet nga ndertimet/prishjet jo te rrezikshme)".

Per sa thame dhe argumentuam me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vendosi mospranimin e ankeses se Operatorit Ekonomik "ECORICIKLIM" SHPK, te ngritura ne shkresen Nr. nr. 2819 prot., date 11.09.2020."

II.11. Në datën 25.09.2020 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.12. Në datën 09.10.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1181/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2819/6 prot., datë 07.10.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.13. Në datën 15.10.2020 nëpërmjet shkresës nr. 1181/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtuar Institutit të Shëndetit Publik, duke i kërkuar si vijon:

“Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konsatojmë se, përsa i përket mbetjeve që gjenerohen nga pacientet me Covid - 19, përvec të tjerave, autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” i referohet edhe shkresës së Institutit të Shëndetit Publik me nr. 417 prot, date 12.03.2020.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, nenit 28 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, neneve 71, 72,73 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj kopje të shkresës tuaj me nr. 417 prot, date 12.03.2020, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj.”

II.14. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1181/3 prot., datë 15.10.2020, Instituti i Shëndetit Publik ka vënë në dispozicion të KPP-së, shkresën nr. 417/1 prot., datë 12.03.2020, drejtuar Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, me përmbajtjen si vijon:

*“Ne përgjigje të shkresës së QSUT-se me nr. 578/65 prot., date 11.03.2020, mbi menyren e asgjësimit të mbetjeve spitalore potencialisht të rrezikshme, bazuar në VKM nr. 798, date 29.9.2010 "Per miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", trajtimi i tyre behet me **Hidroklavim dhe Incenerim.***

Duke iu referuar situates, sugjerojme që, gjenerimi i ketyre mbetjeve duhet të incenerohen në një incinerator të projektuar mirë dhe që funksionon mirë, i cili shkatërron cdo mbetje infektive të rrezikshme, duke i ekspozuar ato ndaj një temperature mjaft të larte për një kohe dhe me oksigjen të mjaftueshem, për të djegur lenden organike.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k se:

“Ne DST e publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik (SPE) per kete procedure prokurimi, shtojcave me ndryshimet perkatese te publikuara ne SPE, si dhe bazuar ne vendimin e KPP-se nr. 258/2020, date 17.07.2020 i cili ka dhene vendimin e tij perfundimtar per pikat e meposhtme per kete procedure prokurimi. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, 3.1.Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: a) [Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B) ku te kete te perfshire Autoklaven, dhe aktivitet pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava / hidroklava duhet të punojë me temperaturë jo më të vogël se 130o C dhe në presion jo më të vogël se 1.1 Bar (e përshkruar në lejen mjedisore)] – Ne lidhje me kete pike u konstatua qe OE “ECO RICIKLIM” Shpk nuk e permbush kete kriter pasi, duke u bazuar ne Lejen Mjedisore qe ky OE ka paraqitur, tek "Pershkrimi i veprimtarise se specifikuar" pajisja e tij nuk punon me presion, kusht ky i kerkuar qartesisht nga AK. Per me teper nga pershkrimi qe eshte bere ne Lejen Mjedisore te ketij OE vihet re se pajisja e tij "Neëster NË50" eshte sterilizues dhe jo autoklave ose hidroklave”, si dhe

“Ne DST e publikuara ne sistemin e SPE per kete procedure prokurimi dhe shtojcave me ndryshimet perkatese te publikuara, Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik: eshte kerkuar ç) [OE për të vërtetuar funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës]. – OE “Eco Riciklim” Shpk ka paraqitur nje vetedeklarate e cila mban daten 18.08.2020 ne te cilen deklaroi se Impiantet e tij jane te lidhur me printera te cilet rregjistrojne dhe printojne cdo detaj te procesit te punes si Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj., Ne printimet qe ky OE ka paraqitur ne DST verehet se printimet e printerit te lidhur me Sterilizuesin jane fotokopje dhe nuk jane as origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as te noterizuara. Gjithashtu vihet re se printeri i lidhur me Sterilizuesin nuk printon presionin, sic eshte kerkuar ne DST, e njejta gje eshte dhe me printimet qe ky OE ka paraqitur ne SPE verehet se printimet e printerit te lidhur me Inceneratorin jane fotokopje dhe nuk jane as origjinale (me vule te njome nga perfaqesuesit e shoqerise) dhe as te noterizuara. Gjithashtu vihet re se printimet e paraqitura per Inceneratorin nuk jane te rregullta pasi ne te ka parregullsi te dukshme si: - Dera e ketij inceneratori rri gjate gjithë kohes e mbyllur, nderkohe qe nga OE pretendohet qe ky incenerator te jete furnizuar me materiale djegje (mbetje spitalore ose medikamente). - Me daten 23.06.2020 ora 13:37 (referuar te dhenave te paraqitura ne printimet e OE) temperaturat ne te dy dhomat e djegies jane 0 °C, por te dy djegesit rezultojne te jene te ndezur (ON) dhe nuk jane fikur deri ne "rindezjen" e rradhes qe sipas dok te paraqitur rezultoi se ka gene data 25.06.2020 ora 19:42. - Gjithashtu ka gabime te shumta ne daten dhe oren, p.sh midis dates 25.06.2020 del dhe nje date 28.06.2020. Ora shumicen e rasteve shkruan duke u kthyer mbrapa, gje e cila ska sens. P.sh 26.06.2020 ora 01:02 me pas printimi tjetër shkruan date 26.06.2020 ora 00:58, ne vend te ishte te pakten pas ores 01:02. - Gjithashtu printeri i lidhur me Inceneratorin nuk printon rregullisht pasi verehet qe here-here printon cdo 4-5 min dhe here-here cdo 20-30 min.4.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, pika 3.1, gërma “a”, e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës si më poshtë vijon:

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a) **Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B)** ku te kete te perfshire **Autoklaven**, dhe aktivitet pershkrues te veprimtarise: Trajtim mbetje spitalore (me autoklavim/hidroklavim). Autoklava/hidroklava duhet të punojë me temperaturë jo më të vogël se 130° C dhe në presion jo më të vogël se 1.1 Bar (e përshkruar në lejen mjedisore),

b) **Leje Mjedisore të Tipit A (Kodi III.1.C)** ku te kete te perfshire **Inceneratorin**, dhe aktivitet përshkruar te veprimtarise: Trajtim mbetje te rrezikshme (spitalore) me Incenerim.

dh) **License III.2.B** te leshuar nga QKB, e vlefshme, ku të ketë të përfshirë metodën e autoklavimit/hidroklavimit, dhe Incenerimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore, **Kodi: 18 01 02**. Metodatat e trajtimit mund të paraqiten në të njëjtën liçensë, apo në liçensa të ndryshme të të njëjtit OE/BOE.

Ndërsa në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, gërma “ç”, është kërkuar:

OE për të vërtetuar funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është parashikuar:

Ne mbështetje te ligjit Nr.9537, date 18.05.2006, te azhurnuar me Ligjin Nr.9890, date 20.03.2008, per “Administrimin e mbetjeve te rrezikshme”, si dhe bazuar ne Rregulloren e Brendshme te Administrimit te Mbetjeve Spitalore, me Nr.1622 Prot., date 20.03.2008, rregullores Nr.6, date 30.11.2007 “Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore”, si dhe ne ligjin Nr.10448, date 14.07.2011.

- 1. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa konfirmimin e kryeinfermierit, personit përgjegjës, të shërbimit përkatës nga ku gjenerohen mbetjet.*
- 2. Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe të kontaminuara që dalin nga pacientët e infektuar me COVID-19, duhet të trajtohen në impiant, i cili është i liçensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.*
- 3. Asgjësimi duhet të realizohet sipas metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e këtij vendimi, ku në veçanti mbejtjet e rrezikshme spitalore dhe të kontaminuar që dalin nga pacientët e infektuar me COVID-10, duhet të trajtohen **me hidroklavim/autoklavim dhe Incenerim.***
- 4. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambientit të shërbimit që do të vendoset nga shërbimi, me automjetin e tij të posaçëm (plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë,*

ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një parët i mbyllur i fiksuar) dhe me ambalazhimin përkatës në përputhje me standartet e OBSH, të furnizuara nga vetë operatori, dhe Udhëzuesin e Ministrisë Shëndetësisë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

5. Të përdorë kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III , trajtimi i mbetjeve spitalore.
6. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, grupi të punës të ngritur për monitorimin e këtij shërbimi, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambalazhimit. Ambalazhimi (kutië, fuçitë, paletat, etj.) do të mbulohet nga subjekti fitues. Gjithashtu pagesa do të bëhet në bazë të kilogrameve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palet.
7. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik.
8. Para marrjes në dorëzim të mbetjeve, do të bëhet dezinfektimi i tyre brenda në shërbim, nga OE, do të mbyllën në kutitë e ambalazhimit.
9. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara. Kjo do të pasqyrohet në proces-verbalin përkatës ditor të mbajtur mes palëve.
10. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.
11. Dokumenti i transferimit të mbetjeve, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a. numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
 - c. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
 - ç. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
 - d. emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
 - dh. përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasinë respektive;
 - e. hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.
12. O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të licencuar për depozitimin e hirit.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimi i Materialeve:

- *Kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmase (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III , trajtimi i mbetjeve spitalore.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k, përsa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor për **Leje Mjedisore Tipi B (Kodi III.1.B)** rezulton janë paraqitur dokumentat si më poshtë vijon:

1. Leje mjedisi e tipit B, për stacion transferimi për mbetje të rrezikshme. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incelerimit (5.1a) ose lëndfillimit (5.2a). Kodi III.1.B. Kategorija: Për ndikimin në mjedis. Kjo leje është lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
2. Akt Miratimi Leje Mjedisi Tipi B me nr. 859 prot., datë 01.02.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Përshkrimi i procesit: Impianti Neëster®NË50 [...].

Përsa i përket kërkesës së “për funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, (ofertuesi) duhet të paraqesë Autodeklarata ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës”, rezulton se operatori ekonomik ankimes “Eco Riciklim” sh.p.k ka paraqitur:

1. Deklaratë datë 18.08.2020 ku deklarohet se: “Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,).
2. Pesë faqe printimi me të dhënat përkatëse në formë tabele dhe grafike të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës”

III.1.4. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.

Ky ligj përcakton:

- a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;
- b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.1.5. Në shtojcën 1, pika 18 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”, përcaktohet:

18 MBETJE NGA KUJDESI SHENDETESOR NJEREZOR OSE SHTAZOR DHE KERKIME QE LIDHEN ME TO (me përjashtim të mbetjeve të guzhinave dhe restoranteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin shendetesor)

18 01 Mbetjet nga kujdesi shendetesor qe nga lindja, diagnoztikimi, trajtimi dhe/ose parandalimi i semundjeve ne njerezit.

18 01 01 Bisturite, shiringa, instrumenta te mprehte (pervec 18 01 03)

18 01 02 Pjese te trupit dhe organe perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (pervec 18 01 03.)

18 01 03 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjесimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet.

18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjесimi i te cilave nuk kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, nderresat, veshje per te asgjесuar, pelena etj)

18 01 06 Kimikate qe konsistojne ose permbajne substanca te rrezikshme.

18 01 07 Kimikate te tjera nga ato te permendura ne 18 01 06

18 01 08 Medikamente citostatika dhe citotoksike

18 01 09 Medikamente te tjera pervec atyre te permendura ne 18 01 08

18 01 10 Mbetje amalgame nga kujdesi dentar

III.1.6. Në VKM Nr.798, date 29.9.2010, "Per miratimin e Rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", lidhur me metodat për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, parashikohet:

1. Incenerim; 2. Autoklavim:a) Presion,b) Presion –avull,c) Presion –avull –copëtim; 3. Sterilizim me mikrovalë; 4. Sterilizim –UV; 5. Trajtim kimik/dizinfektim:a) meshkumës të kloruar;b) me klor aktiv (klor të lirë);c) me peroksid hidrogjeni (H₂O₂);d) me glutinimin e proteinave nëpërmjet përdorimit të acideve;e) me ozon (O₃).

Ndërsa në shtojcën 5, paragrafi i fundit, thuhet se:

“Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.”

III.1.7. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pikat 1, 2 dhe 3 thuhet si më poshtë:

“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose

specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj."

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se: "[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]"

III.1.8. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", në Kreun I, pika 1 dhe 2 Qëllimi dhe Objekti, përcaktohet: "Kjo rregullore përcakton procedurat, rregullat dhe standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit".

a) "Mbetje spitalore" janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve". k) "Mbetje e rrezikshme" përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar".

III.1.9. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.10. Në ankesën e paraqitur nga ankimuesi, lidhur me këtë pikë pretendohet si vijon: "Se pari, AK i është referuar në mënyrë të ngushtë e kufizuese Shtojces 3 dhe Shtojces 5 të VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 "Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore", duke justifikuar kërkesën e vet kufizuese që "Autoklava/hidroklava duhet të punojë me temperaturë jo me të vogël se 130° C dhe në presion jo me të vogël se 1.1 Bar (e përshkruar në lejen mjedisore)", me përcaktimin respektiv në shtojcën 5 "Standartet teknike për Incenerimin dhe Autoklavimin e Mbetjeve Spitalore" të kësaj VKM. Por AK anashkalon faktin që autoklavimi është vetëm një nga teknologjitë e trajtimit/asgjësimit të përcaktuara në listën e Shtojces 3 "Metoda për trajtimin dhe asgjësimin" të VKM Nr. 798, datë 29.9.2010 brenda metodës së sterilizimit. Sidoqoftë kjo listë nuk është një listë e mbyllur dhe ekskluzivisht ezauruese, por është një listë indikuese, pasi teknologjitë përparojnë dhe në një dekadë që ka kaluar nga viti 2010 kur ka

dale VKM ne fjale, nuk mund te pretendosh qe nuk jane zhvilluar e miratuar teknologji me te perparuara qe jo domosdoshmerisht jane ekzaktesisht si ato te listuara ne kete Shtojce 3. Per me teper, parametrat e indikuar nga AK i perkasin ekskluzivisht "autoklavimit me presion", pasi njesia matese "Bar" perdoret pikerisht per matjen e presionit atmosferik dhe nuk mund te jene te aplikueshme per nje teknologji te ndryshme qe sidoqofte realizon te njejtin qellim e funksion si p.sh "hidroklava", e cila nuk eshte nje teknologji qe funksionon me presion, por mbi konceptin e realizimit te sterilizimit nepermjet nxehtes se ujit, prodhimit te avullit dhe hidrolizimit te mbetjeve (perfshire copetimin e tyre) deri ne sterilizim te plote.

Me llogjiken e AK, edhe pse p.sh hidroklavimi eshte nje metode e udhezuar nga ISHP, menyra se si eshte shkruar kerkesa per lejen mjedisore do ta linte jashte gares nje OE qe ofron metoden e sterilizimit me hidroklave (te sugjeruar nga ISHP) ose teknologji ekuivalente, pasi ne lejen mjedisore te ketyre OE nuk do te gjehej pershkrimi i funksionimit "ne presion jo me te vogel se 1.1 Bar", per arsyen e thjeshte se keto teknologji si hidroklava etj, ekuivalente, nuk perdorin presionin me avull, por procese te tjera teknologjike, qe sidoqofte arrijne te njejtin rezultat, ne mos me te perparuar.

Gjithashtu, hidroklavimi eshte parashikuar si teknologji ne DST nga AK, por ne fakt Shtojca 3 e VKM Nr. 798, date 29.9.2010 "Per Miratimin e Rregullores "Per Administrimin e Mbetjeve Spitalore", nuk e liston fare hidroklavimin si metode specifike per trajtimin sterilizues te mbetjeve spitalore.

Se dyti, sqarojme se KVO tregon padijeni dhe mungese te thelle njohurish te fushes, kur thote se pajisja jone eshte sterilizues dhe jo autoklave apo hidroklave. Ne fakt autoklava ne vetvete eshte "sterilizues me avull" ndersa hidroklava eshte "sterilizues me uje me nxehtesi te larte". Pra metoda gjithepershires e trajtimit eshte sterilizim, ndersa autoklava, hidroklava apo edhe patenta te tjera te barazvlefshme ne rezultat jane teknologji qe realizojne kete qellim (sterilizimin). Kjo eshte e qarte edhe nga perkufizimet psh ne kete link:

<https://ëëë.cdc.gov/infectioncontrol/guidelines/disinfection/sterilization/steam.html> apo ne: kete link: <https://en.ëikipedia.org/ëiki/Autoclave>.

Se treti, KVO injoron faktin e qarte ligjor te pershkruar ne menyre te detajuar ne ankesen tone, se autoriteti kompetent per leshimin e Lejeve Mjedisore eshte Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) dhe eshte ky autoritet qe ka qellim te vleresoje nese nje teknologji e caktuar eshte e pershtatshme dhe e lejuar per te operuar ne realizimin e funksioneve dhe mberritjen e rezultateve specifike te aplikuar. Ne keto rrethana, AK nuk mund te perjashtoj nga gara me ane te ketyre percaktimeve kufizuese qe shpien drejt nje OE te vetem, OE te tjere qe jane pajisur rregullisht me Leje Mjedisore nga AKM per te realizuar pikerisht sherbimin qe kerkon AK, pra trajtimin sterilizues te mbetjeve spitalore infektive me autoklavim apo me teknologji ekuivalente. Per te ilustruar sa me siper, bashkelidhim ne kete ankese nje konfirmim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit qe ne cilesine e autoriteteve kompetente konfirmojne vlefshmerine per kete qellim (pra per trajtimin e mbetjeve infektive) te teknologjise FHT (Frictional Heat Treatment) qe ne ngjashmeri/ekuivalece me autoklaven/hidroklaven, funksionon nepermjet proceseve me copetim/bluarje dhe temperatures 150C te induktuar. Gjithashtu, bashkelidhim edhe Certifikaten e Konformitetit te prodhuesit te kesaj teknologjie.

Se katerti, per te siguruar mireperdorim, eficence dhe kursim te fondeve publike, sipas parimeve te LPP, KVO duhej te ishte mbeshtetur posacerisht per kete pike ne nenin 53 pika 4 te LPP

qe percakton se: "Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit... ", per me teper ne kushtet kur ndryshimi ne fjale ne lidhje me parametrat nuk eshte as nje devijim, por ka te beje me disponimin e nje teknologjie me te perparuar se ajo qe ka specifikuar AK dhe, jo vetem qe nuk eshte thelbesisht material, por eshte i shkaktuar nga vete AK per shkak te mosnjohjes se teknologjive. Madje, vlen te shtojme se teknologjia e perdorur prej nesh eshte identifikuar edhe nga OBSH si teknologji e re, me eficente dhe me inovative.

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Eco Riciklim” sh.p.k rezulton se është paraqitur Leje mjedisi me kod III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit me përshkrimin “Leje mjedisi e tipit B, per stacion transferimi per mbetje te rrezikshme. Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme pervec incelerimit (5.1a) ose lendfillimit (5.2a)”, shoqëruar me Akt Miratimi Leje Mjedisi Tipi B me nr. 859 prot., datë 01.02.2018, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Bazuar në Ligjin nr. 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” i ndryshuar, Leje mjedisi e tipit B eshte leja e pergatitur nga Agjencia Kombetare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri [...]. Në rastin konkret, sipas këtij akt miratimi, instalimi per te cilin eshte dhene kjo Leje nuk duhet te vihet ne pune derisa te jene marre masat e meposhtme dhe AKM si autoriteti kompetent te jete njoftuar me shkrim per kete. Konkretisht: *te jene marre te gjitha masat e nevojshme: te pershkuara ne Formularin e Kerkeses per Leje Mjedisi; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per zbatimin e kushteve te Vendimit per VNM Paraprake Nr. 45 Prot, date 13.01.2017, Nr. Identifikimi 12, te Vendimit I, per projektin "Trajtim i mbetjeve spitalore"; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per grumbullimin e ujrave te pastrimit dhe shkarkimin e tyre brenda normave te lejuara ne mjediset ujore pritesë; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per mirembajtien e intalimeve; Te jene marre te masat e nevojshme per mbrojtjen nga zjarri; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per kapjen dhe trajtimin e gazrave/avujve te gjeneruara nga instalimet; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per rrethimin e vendndodhjes ku ushtrohet veprimtaria per transferimin dhe asgjesimin e mbetjeve te rrezikshme; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme qe mbetjet e rrezikshme te ruhen ne ambiente te padeptueshme; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per menaxhimin e integruar te mbetjeve qe asgjesohen nga instalimi dhe te mbetjeve qe gjenerohen nga instalimet; Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per zbatimin e Vendimit Nr. 798, date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore. Pra operatori ekonomik ankimues është pajisur me lejen përkatëse vetëm pasi ka përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi. Në përshkrimin e veprimtarisë së impiantit të shoqërisë “Eco Riciklim” sh.p.k thuhet se: *Impianti Neëster®NE50 është një makineri që përpunon dhe sterilizon mbetjet spitalore potenciale te rrezikshme nëpërmjet trajtimint në nxehtësi nga fërkimi (Fractional Heat Treatment FHT). Teknologjia mbështetet në franksionimin mekanik të mbetjeve dhe procese termike në mjedis të lagësht për të arritur inaktivizimin e florës mikrobiale. Makinaria përbëhet nga disa pjesë me funksione përkatëse në procesin e punës, si grupi i enës kryesore, grupi i condensës, grupi i filtrave, ena e shkarkimit grupi i inverterit, bordi elektrik dhe pompa e vajit. Mbetjet në fillim i nënshtrohen procesit mekanik të grirjes. Në enën kryesore të sterilizimit helika e fuqishme shpërbën, grin dhe përzien mbetjet të cilat njëkohësisht nxehen në**

efektin e fërkimit dhe rezistencës. Temperatura e grimcave të mbetjeve matet në kohë reale dhe me saktësi maksimale nga sensorë të vecantë që masa shkon të përzihet. Kur temperatura arrin në 150°C, masa e mbetjeve spërkatet automatikisht me ujë në mënyrë që temperature të ulët. Mbetjet e trajtuara ftohen në 95°C. [...].

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi, i pajisur me licencat përkatëse sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj dhe dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, krijon bindjen se nga ana e këtij të fundit disponohet licenca e kërkuar nga autoritetit kontraktor për realizimin e kontratës pasi aktiviteti i tij është njohur nga institucionet kompetente që kanë bërë licencimin e tij në bazë të legjislacionit në fuqi. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se teknologjia e propozuar nga operatori ekonomik ankimues për kryerjen e shërbimit, nuk deklarohet se nuk përmbush synimin e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor si edhe sigurinë dhe rëndësinë e objektit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1181/3 prot., datë 15.10.2020, Instituti i Shëndetit Publik ka vënë në dispozicion të KPP-së, shkresën nr. 417/1 prot., datë 12.03.2020, drejtuar Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, me përmbajtjen si vijon: “*Duke iu referuar situates, sugjerojme qe, gjenerimi i ketyre mbetjeve duhet te incenerohen ne nje incinerator te projektuar mire dhe qe funksionon mire, i cili shkaterron cdo mbetje infektive te rrezikshme, duke i ekspozuar ato ndaj nje temperature mjaft te larte per nje kohe dhe me oksigjente mjaftueshem, per te djegur lenden organike.*” Në rastin konkret KPP gjykon se metoda e propozuar nga operatori ekonomik ankimues nuk vjen në kundërshtim me metodologjinë e sugjerua të incenerimit të mbetjeve nga organi kompetent. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues disponon lejet e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit për mbetjet në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe kodet përkatëse.

Përsa i përket kërkesës se “*për funksionalitetin e Autoklavës/Hidroklavës dhe Inceneratorit, (ofertuesi) duhet të paraqesë Autodeklaratë ku të deklarojë se Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,). Autodeklarata duhet të shoqërohet me disa printime (2 ose 3 printime) të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës*”, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Eco Riciklim” sh.p.k ka paraqitur Deklaratë datë 18.08.2020 ku deklarohet se: “*Autoklava/Hidroklava dhe Inceneratori janë të pajisura me printer i cili regjistron dhe printon çdo detaj të procesit të punës (Ndezja, Hapja e Pajisjes, Fillimi i Procesit të Punës, Temperaturën, Presionin etj.,) si dhe pesë faqe printimi me të dhënat përkatëse në formë tablele dhe grafike të autoklavës/hidroklavës dhe inceneratorit, gjatë 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës*”, në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor si më sipër cituar dhe teknologjinë e propozuar nga ankimuesi.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave

të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik "Eco Riciklim" sh.p.k se: *"Ne DST Kriteret e vecanta te kualifikimit: 3.3 Kapaciteti teknik, eshte kerkuar: [Të vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklavë/hidroklave) dhe asgjësimit me incenerator, operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill të licensuar apo i eksporton jashtë Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim duhet të dorëzoje:*

- Kontratë të vlefshme me Landfill të licensuar per depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit. - Kontratë të vlefshme me Landfill të licensuar per depozitimin e hirit qe del nga asgjësimi i mbetjeve spitalore me incenerim.

- Kopje te licences se landfillit (për mbetjet e trajtuara me autoklave dhe per hirin) ku te cilësohet se eshte i licensuar per grumbullimin e ketyre lloj mbetjesh.

- Në rastin e eksportit, Kontratë me subjekt të licensuar për eksportin jashtë RSH ose Autorizim për Eksport të Mbetjeve / Produkteve (hirit) që dalin nga Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve.

OE Eco Riciklim ka paraqitur dy kontrate (akt-marreveshje), me "Albtek Energy shpk" dhe me "Integrated Energy BV SPV shpk", nga verifikimet e kryera verehet se te dyja keto akt-marreveshje jane vetem per mbetjet spitalore te trajtuara, pra vetem per depozitimin e mbetjeve pas trajtimit me Sterilizues (autoklave/hidroklave), dhe jo per depozitimin e hirit qe del nga djegia e mbetjeve spitalore. Vetem tek akt-marreveshja me Albtek Energy shpk, neni 5.1 i kesaj akt-marreveshje shkruhet se Eco Riciklim ne rast se do duhet te depozitoje tipologji tjeter mbetjeje (ne rastin tone Hirin) duhet te beje kerkese me email dhe vetem pas kerkeses duhet te nenshkruajne akt-marreveshje te re. Nga dokumentat e paraqitura ne SPE nga ky OE nuk figuron asnje dokument apo akt-marreveshje qe verteton se ky OE ka per depozitimin e hirit qe del pas djegies se mbetjeve spitalore. Gjithashtu, referuar dhe komunikimit nga ana jone me Agjensine Kombetare te Mjedisit (AKM) si autoritet kompetet ku i kerkuam te na sqaronin nese subjekti "ALBTEK ENERGY" shpk me NIPT: L41914013H eshte i licencuar te grumbulloje nga pale te treta hirin qe del si rezultat i asgjësimit me incenerim te mbetjeve te rrezikshme spitalore infektive? AKM me ane te pergjigjes se saj na informon se operatori "Albtek Energy" disponon leje mjedisore per "Landfillimin e mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve urbane te qarkut te Elbasanit". Ndersa Landfilli i Tirane me Shoqerine Integrated Energy BV SPV" Shpk, Licensa dhe Leja e Mjedisit bashkelidhur per kete shoqeri, ka pershkrimin e aktivitetit te pershkruar: Grumbullim, ruajtje dhe asgjësim i mbetjeve urbane, dhe Lloji i mbetjeve: "Mbetje urbane dhe mbetjet nga ndertimet/prishjet (jo te rrezikshme)" Per sa me siper argumentuam, OE Eco Riciklim nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST nga AK, sipas përcaktimeve të nenit 53, pika 3, 5/c, dhe

nenit 54 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, gërma “e” të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se është kërkuar shprehimisht:

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

Të vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklavë/hidroklave) dhe asgjësimit me incenerator, operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill të licencuar apo i eksporton jashtë Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim duhet të dorëzojë:

- Kontratë të vlefshme me Landfill të licencuar për depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.
- Kontratë të vlefshme me Landfill të licencuar për depozitimin e hirit që del nga asgjësimi i mbetjeve spitalore me incenerim.
- Kopje të licencës së landfillit (për mbetjet e trajtuara me autoklave dhe për hirin) ku të cilësohet se është i licencuar për grumbullimin e ketyre llojeve mbetjesh.
- Në rastin e eksportit, Kontratë me subjekt të licencuar për eksportin jashtë RSH ose Autorizim për Eksport të Mbetjeve / Produkteve (hirit) që dalin nga Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve.

III.2.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” është parashikuar:

Ne mbështetje të ligjit Nr.9537, date 18.05.2006, të azhurnuar me Ligjin Nr.9890, date 20.03.2008, për “Administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, si dhe bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore, me Nr.1622 Prot., date 20.03.2008, rregullores Nr.6, date 30.11.2007 “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore”, si dhe në ligjin Nr.10448, date 14.07.2011.

13. *Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa konfirmimin e kryeinfermierit, personit përgjegjës, të shërbimit përkatës nga ku gjenerohen mbetjet.*
14. *Mbetjet e rrezikshme spitalore dhe të kontaminuara që dalin nga pacientët e infektuar me COVID-19, duhet të trajtohen në impiant, i cili është i licencuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.*
15. *Asgjësimi duhet të realizohet sipas metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara në VKM nr 798 date 29.09.2010, shtojca 3 e këtij vendimi, ku në veçanti mbetjet e rrezikshme spitalore dhe të kontaminuar që dalin nga pacientët e infektuar me COVID-10, duhet të trajtohen me hidroklavim/autoklavim dhe Incenerim.*
16. *Mbetjet do të merren nga sipërmarreësi pranë ambjentit të shërbimit që do të vendoset nga shërbimi, me automjetin e tij të posaçëm (plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar) dhe me ambalazhimin përkatës në përputhje me standartet e OBSH, të furnizuara nga vetë operatori, dhe Udhëzuesin e Ministrisë Shëndetësisë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.*
17. *Të përdorë kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “Për*

administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III , trajtimi i mbetjeve spitalore.

18. *Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, grupi të punës të ngritur për monitorimin e këtij shërbimi, ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambalazhimit. Ambalazhimi (kutië, fuçitë, paletat, etj.) do të mbulohet nga subjekti fitues. Gjithashtu pagesa do të bëhet në bazë të kilogrameve të tërhequra sipas proces-verbaleve të firmosur nga të dyja palet.*
19. *Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik.*
20. *Para marrjes në dorëzim të mbetjeve, do të bëhet dezinfektimi i tyre brenda në shërbim, nga OE, do të mbyllen në kutitë e ambalazhimit.*
21. *Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara. Kjo do të pasqyrohet në proces-verbalin përkatës ditor të mbajtur mes palëve.*
22. *Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.*
23. *Dokumenti i transferimit të mbetjeve, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:*
 - a. *numrin e dokumentit të dorëzimit;*
 - b. *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;*
 - c. *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;*
 - ç. *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);*
 - d. *emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;*
 - dh. *përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasinë të respektive;*
 - e. *hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.*
24. *O.E duhet të dorëzojë mbetjet e dala nga përpunimi, në një subjekt të liçensuar për depozitimin e hirit.*

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimi i Materialeve:

- *Kontenierë njëpërdorimsh plastike ose kuti kartoni me qese plastmasi (furnizim që e kryen OE) sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III , trajtimi i mbetjeve spitalore.*

III.2.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k, rezulton janë paraqitur dokumentat si më poshtë vijon:

1. Akt marrëveshje lidhur në datën 07.01.2020 midis palëve Integrated Energy BV SPV sh.p.k dhe “Eco Riciklim” sh.p.k.
Qëllimi i aktmarrëveshjes është: “Eco Riciklim” sh.p.k, do te depozitoje cdo mbetje te gjeneruar te llojit spitalore te trajtuara, prane Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane (ZTMT), Sharre, duke njoftuar paraprakisht me e-mail ne adresen zyrtare te shoqerise koncesionare: info@iebv.al, per dergesen per depozitim, minimalisht 24 ore perpara nisjes se mjetit qe do te kryeje transportin e tyre.Kjo aktmarreveshje është shoqëruar me Licencën III.2.B të shoqërisë Integrated Energy BV SPV sh.p.k dhe Akt miratimin e licencës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në emër të shoqërisë Integrated Energy BV SPV sh.p.k.
2. Akt marrëveshje lidhur në datën 01.08.2020 midis palëve “Albtek Energy” sh.p.k dhe “Eco Riciklim” sh.p.k.
Qëllimi i aktmarrëveshjes është: “Eco Riciklim” sh.p.k, do te depozitoje cdo mbetje te gjeneruar te llojit spitalore te trajtuara, prane venddepozitimit te ri Qarku Elbasan; duke njoftuar paraprakisht me e-mail ne adresen zyrtare te shoqerise koncesionare: info@albtek-energy.al per dergesen per depozitim, minimalisht 24 ore perpara nisjes se mjetit qe dote kryeje transportin e tyre.
Kjo aktmarreveshje është shoqëruar me Licencën III.2.B të shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k dhe Akt miratimin e licencës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në emër të shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k.

III.2.4. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pikat 1, 2 dhe 3 thuhet si më poshtë:

“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.”

III.2.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.2.6. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.7. Në ankesën e paraqitur nga ankimesi, lidhur me këtë pikë pretendohet si vijon: “KVO pretendon se nga ana jone nuk përmbushet kriteri 3.3.e i Kriterëve të Veçanta për Kualifikim: Ne Dokumentat e Tenderit, Shtojca 8, pika 3.3.e kërket si vijon:

e) Te vërtetojë nepermjet dokumentacionit se pas trajtimit të mbetjeve spitalore (sterilizimit me autoklave/hidroklave) dhe asgjësimit me incenerator, operatori i dorëzon mbetjet e trajtuara në landfill të licensuar apo i eksporton jashtë Republikës së Shqipërisë, për këtë qëllim duhet të dorëzojë:

- Kontrate të vlefshme me Landfill të licensuar për depozitimin e mbetjeve spitalore pas trajtimit.
- Kontrate të vlefshme me Landfill të licensuar për depozitimin e hirit që del nga asgjësimi i mbetjeve spitalore me incenerim.
- Kopje të licencës së landfillit (për mbetjet e trajtuara me autoklave dhe për hirit) ku të cilesohet se është i licensuar për grumbullimin e këtyre llojeve mbetjesh.
- Në rastin e eksportit, Kontrate me subjekt të licensuar për eksportin jashtë RSH ose Autorizim për Eksport të Mbetjeve të Produkteve (hirit) që dalin nga Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbetjeve.

Se pari sqarojmë skualifikimin tone:

Sipas KVO, ky kriter nuk përmbushet nga ana jone pasi:

a. Sipas KVO, asnjë nga Kontratat e dorëzuara nga ana jone respektivisht me Albtek Energy (Elbasan) dhe me Integrated Energy BV SPV (Sharre, Tirane), nuk është për depozitimin e hirit që del nga djegia e mbetjeve spitalore.

Ky pretendim i KVO është thjesht i pavërtetë. Nëse verifikohet me kujdes Kontrata me Albtek Energy, nën 2.4 referon si pjesë integrale aneksin përkatës në të cilën është cilesuar se cilat janë llojet e mbetjeve që pranohen si dhe parametrat e tyre të pranueshme dhe në këtë aneks, hiri është një prej tyre. Për më tepër, në Lejen Mjedisore të Albtek Energy që është pjesë përberëse e kontratës, në faqen 37 të saj, qartësisht rezulton se ky subjekt është i autorizuar të grumbullojë "Mbetje nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve" që përfshihen në grupin e kodeve 19 01, ku përfshihen edhe kodet 19 01 11 dhe 19 01 12, që janë dy kategoritë ku mund të klasifikohet hiri i inceneratorit. Në kushtet kur në rastin konkret, mbetjet do të trajtohen fillimisht

me sterilizim, pra do te shnderrohen nga te rrezikshme ne te parrezikshme (pra urbane) dhe pastaj do te futen per incenerim, rezulton se kodi i hirit eshte 19 01 12, me perjashtim te ndonje rasti te vecante kur nga analizat mund te rezultojne me kodin 19 01 11.

Sipas KVO nga ana jone duhej te ishte paraqitur nje kontrate shtese e lidhur me Albtek Energy ne menyre te posacme per hirin, pasi sipas KVO hiri qe del nga asgjessimi me incelerim nuk perfshihet ne objektin e kesaj kontrate.

Edhe ky pretendim i KVO, ne vijim te sqarimit te mesiperm eshte i pavertete dhe i pabazuar, pasi objekti i kontrates eshte pikerisht depozitimi i mbetjeve te gjeneruara nga trajtimi me incenerim i mbetjeve spitalore, pra, nuk behet fjale per nje tipologji mbetjesh te paperfshire ne objektin e kontrates qe te jete e nevojshme nje lajmerim i posacem me email dhe lidhja e nje aneks kontrate. Ne fakt, ne ne vijimesi kemi depozituar hirat tek kjo shoqeri, dhe qe AK te bindet per kete, edhe pse nuk eshte kerkuar ne DST po i bashkelidhim kesaj ankese nje praktike depozitimi.

c. KVO, i referohet edhe nje komunikimi me AKM, ku kjo e fundit i konfirmon se Albtek Energy eshte i pajisur rregullisht me leje mjedisore per landfillimin e mbetjeve qe gjenerohen nga proceset e incenerimit te mbetjeve ne qarkun e Elbasanit.

Per ne eshte e paqarte cfare do te tregoje KVO me referimin e ketij komunikimi, pasi ne thelb, pergjigja e AKM konfirmon pikerisht qendrimin tone te mesiperm, pra qe shoqeria Albtek Energy eshte e pajisur me Lejen Mjedisore te nevojshme per te grumbulluar hirat e incenerimit.

III.1.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Eco Riciklim” sh.p.k rezulton se në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor janë paraqitur dy akt marrëveshje për depozitimimin e mbetjeve dhe konkretisht akt-marrëveshja e lidhur me kompaninë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k dhe ajo e lidhur me kompaninë “Albtek Energy” sh.p.k. Sipas aktmarrëveshjes së lidhur me kompaninë “Albtek Energy” sh.p.k rezulton se qëllimi i saj është që “Eco Riciklim” sh.p.k te depozitoje cdo mbetje te gjeneruar te llojit spitalore te trajtuara, prane venddepozitimit te ri Qarku Elbasan; duke njoftuar paraprakisht me e-mail ne adresen zyrtare te shoqerise koncesionare info@albtek-energy.al per dergesen, per depozitim, minimalisht 24 ore perpara nisjes se mjetit qe do te kryeje transportin e tyre. Gjithashtu në pikën 2.4 të kësaj aktmarrëveshje, fjalia e fundit, është parashikuar: “[...] Gjithashtu Aneksi I "Mbi kushtet e perpunimit", bashkangjitur eshte pjese integrate e kesaj akt marreveshje.”

Aneksi nr. 1, bashkëngjitur këtij dokumenti, në paragrafin e dytë parashikon shprehimisht: “HIRET 600 °C: Hiri eshte mbetja e ngurte nga djegia. Perberja kirnike e sakte e hirit varion sipas tipologjise se vecante te djegesit nga e cila ka prejardhjen dhe temperatura e djegies. Eshte e perbere nga substance fortesisht te oksiduara dhe me temperature shperndarje dhe avullimi shume te larta si perberjet jonike te metaleve, ne vecanti karbonet dhe oksidet, dhe e varfer me perberje te elementeve te lehte, dhe ka mungese uji”. Ndërsa sipas dokumentit “Akt-Miratimi Licencë e kategorisë III.2.B.” për kushtet e licencës së shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k, në pikën “c” të saj është parashikuar që “Subjekti te administroje e te klasifikoje mbetjet e krijuara nga veprimtaria ne perputhje me (Vendimi Nr. 99, date 18.2.2005 "PER MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TE KLASIFIKIMIT TE MBETJEVE" te ndryshuar Shtojca I) perfshire mbetjet e rrezikshme dhe jo te rrezikshme sipas operacioneve te percaktuara ne lejet mjedisore tipi A me PN-1423-12-2015 dhe PN-5783-09-2017”, ku përfshihen, përveç të tjerave,

19 01	<i>Mbetje nga inceneratorët ose piroliza e mbetjeve</i>
19 01 11*	<i>Hira fundore dhe llumra që përmbajnë substanca të rrezikshme</i>
19 01 12	<i>Hira fundore dhe llumra, të tjera nga ato të përcaktuara në 19 01 11</i>
19 01 13	<i>Hi fluturues që përmbajnë substanca të rrezikshme</i>

Etj.

Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimes, përsa i përket hirit, është paraqitur aktmarrëveshja përkatëse me shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k, për depozitimin e mbetjeve të gjeneruara të llojit spitalore të trajtuara, pjesë e të cilës është edhe aneksi nr.1, si më sipër cituar. Në bazë të “Akt-Miratimi Licencë e kategorisë III.2.B.” të shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k, rezulton se kjo shoqëri është e licencuar të grumbullojë nga pale të treta hirit që del si rezultat i asgjësimit me incenerim të mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi kualifikimin e shoqërisë “Medi-Tel” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit ekonomik për të cilët paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur me vlerë më të lartë se e tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa mësipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi ofertën e shoqërisë “Medi-Tel” sh.p.k” sh.p.k., nuk do të merren në shqyrtim

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” shpk për procedurën e prokurimit Nr. REF-61075-06-11-2020 me objekt: *“Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve që dalin nga shërbimi ku marrin trajtim pacientët me COVID-19, marrëveshje kuadër me afat 12 muaj”*, me fond limit 14’016’000 leke pa TVSH, zhvilluar me dt. 06.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eco Riciklim” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1181 Protokolli

Datë 25.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri